Pagat dhe medijtjet gjatë periudhës raportuese kapin shumën prej **9,688,346.63 €**.

Në krahasim me periudhën janar - qershor të vitit **2024** pagesat për këtë kategori buxhetore shënojnë dinamikë më të ulta për **20.92 %**

ndërsa , plani për vitin **2025** është realizuar **49.34 %** .

Në shumën e gjithmbarshme të shpenzimeve buxhetore pagat dhe medijtjet marrin pjesë me **49.60%** .

Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar **2,801,839.34 €** ose **14.35 %** të shpenzimeve të gjithmbarshme . Në raport me periudhën krahasuese dinamika e tyre është më e shpejtë për **13.42 %** ndërsa plani vjetor është realizuar **52.45 %** .

Shpenzimet komunale për gjashtë muaj të vitit **2025** përbëjnë **2.86 %** të shpenzimeve të gjithmbarshme buxhetore .

Pagesat për këtë kategori buxhetore arrijnë shumën prej **557,921.59 €**. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shpenzimet komunale shënojnë rritje për **2.05 %** ndërsa , plani për vitin **2025** është realizuar **52.89 %** .

Pagesat për transfere dhe subvencione shënojnë dinamikë më të shpejte për **41.90 %** dhe arrijnë shumën **750,616.96 €** ndërsa plani për vitin **2025** është realizuar **62.32 %**. Në shumën e gjithmbarshme të shpenzimeve pagesat për transfere dhe subvencione marrin pjesë me **3.84 %**.

Dinamikë më të shpejtë në raport me periudhën krahasuese shënojnë pagesat për investime kapitale **83.80 %** dhe të njëjtat paraqesin **29.35 %** të shpenzimeve të gjithmbarshme buxhetore për këtë periudhë. Në fund të periudhës raportuese shpenzimet për investime kapitale arrijnë shumën prej **5,732,407.98 €** .

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic of Kosovo

**Komuna e Pejës**

Opština Peć

Peja Municipality

**Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër /Direkcija za Geodezija i Kataster
/Department of Geodesis and Cadastre**

PËR/ZA/TO:	z.Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Mustafë Nila, Drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër
NGA/OD/FROM:	z.Fjolla Kasapolli, UD si Shef i Sherbimit Juridik-Administrativ
LËNDA:	Raporti i punës për periudhën 03.01.2025. - 30.06.2025.
Data:/Datum:/Date:	07.07.2025.

Nr.	EMËRTIMI I LËNDËS	Numri i lëndëve
1	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TERREN	30
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	30
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	0
2	NUMRI I LËNDËVE NGA GJEODETAT PRIVAT	449
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	443
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	6
3	NUMRI I LËNDËVE PËR BARTJE TË PRONËS	1419
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	1370
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	49
4	NUMRI I LËNDËVE PËR HISTORIAT TË PRONËS	65
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	65
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	0
5	NUMRI I LËNDËVE PËR REGJISTRIM/FSHIRJE TË HIPOTEKAVE	224
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	221
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	3
6	NUMRI I LËNDËVE PËR LEGALIZIM	70
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	65
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	5

7	NUMRI I LËNDËVE PËR KORRIGJIM TË DHËNAVE	44
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	38
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	6
8	NUMRI I KËRKESAVE PËR FLETA POSEDUESE DHE KOPJE TË PLANIT	4454

RAPORT 6 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NGA INSTITUCIONET E DKRS NË 2025

D.K.R.S

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Shpallja e Sportistit të Vitit	Me qëllim të motivimit dhe vlerësimit të sportistëve më të suksesshëm dhe klubeve sportive që kanë shënuar rezultate të larta, është organizuar ceremonia madhështore “Sportisti i Vitit 2024”. Në këtë ngjarje u vlerësuan arritjet individuale dhe kolektive, duke theksuar rolin e sportit në promovimin e një jete aktive dhe të shëndetshme.	15 Janar
2	Mbështetja me Subvencione për Organizatat Kulturore, Rinore dhe Klubet Sportive	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur thirrjen për mbështetje me subvencione me anë të projekt propozimeve për organizatat kulturore, rinore dhe klubet sportive, duke vënë në dispozicion një fond prej 300,000 euro, nga i cili kanë përfituar mbi 60 organizata kulturore, rinore dhe klube sportive të qytetit tonë.	3 Shkurt - 10 Mars
3	Aktivitetet për Ditën e Pavarësisë	Në shënim të Ditës së Pavarësisë, u organizuan ekspozita artistike, koncerte argëtuese dhe aktivitete të tjera kulturore.	17 Shkurt
4	Organizimi i Gjimnazjadës 2025	Në bashkëpunim me Sportin Shkollor, është organizuar Gjimnazjada 2025, Qyteti i Pejës hapi dyert për nxënësit e 77 shkollave nga mbarë Kosova të cilët u bënë pjesë e spektaklit sportiv. Afro 700 nxënës të ardhur nga 26 Komuna të Kosovës garuan në kategori të ndryshme sportive ku më të dalluarit u shpërblyen me çmime fituese. Futbolli, basketbolli, futsalli, shahu, volejbolli dhe hendbolli ishin disa prej sporteve garuese gjatë këtij eventi.	21 -22 Prill

5	Aktivitetet për Ditën Botërore të Tokës	Në bashkëpunim me OJQ Gjeravica Pejë, është realizuar një aktivitet simbolik me mbjelljen e qershivë japoneze nën sloganin “Peja ime – Planeti im”, si pjesë e fushatës vetëdijësuese për mbrojtjen e mjedisit.	22 Prill
6	Mbështetja për Zejtarët e Pejës	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka nënshkruar memorandumet e bashkëpunimit me Shoqatën e Zejtarëve të Pejës, për ofrimin e subvencioneve për zejtarët e Pejës. Nga kjo iniciativë që synon ruajtjen dhe zhvillimin e artizanëve të qytetit tonë, kanë përfituar 15 zejtar të Pejës.	15 Maj
7	Inaugurimi i “Sheshit Italia”	Me rastin e Ditës së Republikës së Italisë, në bashkëpunim me Ambasadën e Italisë dhe institucionet lokale, u organizua ceremonia e inaugurimit të “Sheshit Italia” në qytetin e Pejës. Ky projekt synon forcimin e marrëdhënieve kulturore dhe historike mes dy vendeve, si dhe ofrimin e një hapësire të re publike për qytetarët tanë.	30 Maj
8	Crossi 2025 – Aktivitet Sportiv për Ditën e Fëmijëve	Me rastin e 1 Qershorit, u mbajt Crossi 2025 ku morën pjesë fëmijë nga shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Pejës, duke promovuar jetesën aktive dhe sportin që në moshë të hershme.	1 Qershor
9	Aktivitetet për Ditën e Çlirimit të Pejës	Dita e Çlirimit të qytetit u shënuar me një varg aktivitete. Në kuadër të këtij manifestimi, u organizua ceremonia solemne për ndarjen e çmimeve të nderit, duke vlerësuar personalitetet dhe kontribuuesit më të shquar të jetës kulturore, ekonomike dhe shoqërore të komunës së Pejës.	16 Qershor
MUZEU I PEJËS			

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Festojmë Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës'	Performancë artistike me vallëzim dhe recitim të nxënësve të paraleles parashkollore të SHFMU 'Rilindja' nga fshati Llutogllavë. Fëmijët erdhën në Muze të veshur me veshje kombëtare dhe të shoqëruar nga mësuesja. Përveç vizitës Muzeut, nxënësit interpretuan disa pika artistike si: vallëzim i valleve tona tradicionale dhe recituan vjersha kushtuar Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.	14 Shkurt, 2025
2	Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike	Lligjeratë vetëdijësuese dhe informative për trashëgiminë arkeologjike të Rajonit të Pejës. Lligjerata 'Trashëgimia Kulturore Arkeologjike' u mbajt në Qendrën Kreative 'Dukagjini' para nxënësve dhe mësimeve të shkollave fillore dhe ato të mesme të Komunës së Pejës si: SHFMU 'Asdreni'. gjimnazi 'Bedri Pejani', shkollat e Artit 'Odhise Paskali', si dhe përfaqësuesve të QRTK-IMM.	18 Prill, 2025
3	Dita Ndërkombëtare e Muzeut'	Muzeu i Pejës, tani e 15 vite shënon Ditën Ndërkombëtare të Muzeve me aktivitete të ndryshme. Këtë vit është prezentuar një frizurë e viteve të '50, e quajtur 'TOVALET', që hyn në trashëgiminë shpirtërore dhe materiale të trevës së Dukagjinit. Edhe ky prezentim u zhvillua në Qendrën Kreative 'Dukagjini', ku të pranishëm ishin, kryesisht, qytetarë të nderuara të qytetit, si dhe drejtuesha e DKRS, znj. Xhenet Syka-Kelmendi. Në fund të prezentimit, të pranishmit u gostitën me një koktej të dhuruar nga humanistja nga Zvicra, znj. Behide Hasanaj.	19 Maj, 2025

Biblioteka "Azem Shkreli" në Pejë

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Qytetari Digjital (Punëtori / trajnime praktike në grup)	Aktiviteti "Qytetari Digjital" i organizuar nga Biblioteka "Azem Shkreli" synon të ofrojë hapësira edukative për anëtarët e rinj të bibliotekës, përmes punësive praktike që zhvillohen rreth përdorimit dhe programimit të pajisjeve teknologjike moderne. Fëmijët dhe të rinjtë marrin pjesë në seanca të strukturuar, ku njoftohen dhe trajnohen për përdorimin e pajisjeve si: Micro:bit DIY Electronics Kits Bosan Kits Robota edukativë 3D Printer Qëllimi i këtij aktiviteti është të: Nxisë shkathtësitë digjitale dhe të menduarit kritik që në moshë të re Edukojë gjeneratat e reja për të qenë përdorues aktivë dhe krijues të teknologjisë, jo vetëm konsumues. Fuqizojë rolin e bibliotekës si një hapësirë moderne edukimi joformal dhe inovacioni.	03.01.2025- 27.06.2025
2	Aftësimi profesional për bibliotekonomi për nxënës e shkollave të mesme (Punëtori praktike dhe trajnim tematik)	Biblioteka "Azem Shkreli" ka realizuar një cikël punëtorish dhe trajnimesh me nxënës të shkollave të mesme, me fokus në aftësimin profesional në fushën e bibliotekonomisë. Aktiviteti synon të ofrojë njohuri praktike dhe teorike mbi funksionimin e një biblioteke moderne, duke krijuar mundësi për zhvillim të shkathtësive dhe orientim të hershëm profesional.	21.02.2025 16.04.2025
3	Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë 2 Prilli (Aktivitet informues për rëndësin e librit)	Në Ditën Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë, Shkolla Filllore "Xhemajl Kada" dhe dy klasa nga Shkolla Filllore "Asdreni" vizituan Bibliotekën "Azem Shkreli" dhe me fëmijët e këtyre shkollave organizuan aktivitete, ku fëmijët u njohën me shërbimet tona, recituan poezi dhe dhanë mesazhe për dashurinë ndaj librit.	02.04.2025
4	Dita Botërore e Librit dhe të Drejtave të Autorit (23 Prilli) (Aktivitet informues për rëndësin e librit)	Në Ditën Botërore të Librit dhe të Drejtës së Autorit, ka filluar të festohet një javë më herët, sepse ka pas të interesuar shumë shkolla dhe i kam sistemuar nga data 16.04.2025 deri me datën 23.04.2025. Shkollat e interesuara për këtë aktivitet ishin Shkolla Filllore "Xhemajl Kada", "Asdreni", "Lidhja e Prizrenit", "8 Marsi", "Ramiz Sadiku" ku e vizituan Bibliotekën "Azem Shkreli" dhe me fëmijët e këtyre shkollave organizuan aktivitete brenda sallave të Bibliotekës, ku fëmijët u njohën me shërbimet bibliotekare, recituan poezi dhe dhanë mesazhe për dashurinë ndaj librit.	16.04.2025 18.04.2025 21.04.2025 22.04.2025 23.04.2025

5	1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	Me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, në bashkëpunim me organizatën “The Library Project”, dhe me fëmijët e kopshtit "Pëllumbat e Paqës", në Bibliotekën “Azem Shkreli” u organizua aktiviteti me temën: “Zhvillimi i leximit në fëmijërinë e hershme”. Fëmijët patën mundësinë të përjetojnë magjinë e librit përmes leximit të përbashkët, tregimeve të ilustruara dhe aktiviteteve edukative që nxisin dashurinë për librin që në hapat e parë të jetës. Aktiviteti përfshiu edhe prindërit, të cilët u përfshinë në biseda rreth rëndësisë së leximit të hershëm dhe ndikimit të tij në zhvillimin e fëmijëve.	03.06.2025
6	Orë letrare kushtuar Ditës së Çlirimit të Pejës- me karakter garues dhe edukativ	Me rastin e Ditës së Çlirimit të Pejës, në ambientet e Bibliotekës “Azem Shkreli” u organizua një aktivitet kulturor-letrar me karakter solemn dhe edukativ. Aktiviteti kishte për qëllim të nderojë sakrificën e brezave që sollën lirinë dhe të kultivojë ndjenjën e përkatësisë dhe dashurisë për atdheun te brezat e rinj. Ngjarja përfshiu një Orë Letrare me karakter garues, në të cilën morën pjesë nxënës të shkollave fillore të komunës së Pejës. Nxënësit prezantuan krijimet e tyre origjinale – poezi, tregime dhe interpretime letrare – që pasqyruan ndjenja të thella patriotike dhe artistike. Pjesëmarrës ishin nxënës nga disa shkolla fillore të komunës së Pejës Poetë dhe krijues nga Shoqata e Krijuesve Letrar Stafi i bibliotekës, mësimdhënës, prindër dhe dashamirë të librit dhe letërsisë .	13.06.2025

Qendra Multi-profesionale ne Novoselle

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Dita e botes se eger	Per nder te dites nderkombetare te botes se eger te pranishem patem fotografine e njohur Arian Mavriqi cili permes pamjeve te shumta permes projektorit l'u spjegoi nxeneseve se si arrin te marre pamje dhe ngjarje interesante nga bota e eger si ne Kosove dhe jashte saj	03.03.2025
2	Epopeja e UCK-se,5 6 7 marsi	Per nder te ketyre datave te rendesishme per popullin tone ne organizuam nje aktivitet per te nderuar jeten dhe vepren e familjes Jasharaj te cilet sakrifikuan per kete vend	05.03.2025
3	Festa e 7 dhe 8 marsit	Festa e mesuesit dhe festa e nenes u festuan ne Qendren Multi-profesionale se bashku me nxenesit e sh.f.m.u Sami Frasheri(Ozdrim)	05.03.2025
4	Dita boterore e poezise	Ne kete date organizuam nje aktivitet me mesuesen Eva Vllasi dhe nxenesit e saj te cilet recituan poei te bukura kushtar kesaj dite,poashtu shpallem tri poezit me te bukura	21.03.2025

5	Dita e lumturise	Lumturia vjen nga brenda e sidomos veprate mira qe bejme na lumturojne edhe me shume	21.03.2025
6	Dita boterore e ujit	Pa uje nuk ka jete,keshtu u quajte aktiviteti I sotem ne Qendren Multi-profesionale,nxenesve I'u folem per rendesine e ujit dhe kursimin e tij	22.03.2025
7	Dita e Kushtetutes	Organizuum nje aktivitet me nxenes per nder te kesaj dite	09.04.2025
8	Kendi Muze	Ne kete dite patem musafir nje klase me nxenes nga sh.f.m.u Dardania (Peje)me mesuesen Marigona Myrtaj	29.04.2025
9	Dita e punes	Aktivitet I bukur me nxenes,secili prej tyre ushtroi profesionin e endrrave per pak caste	01.05.2025
11	Dita nderkombetare e familjes	Me nxenesit e nivelit parashkollor dhe mesuesen e tyre Blerina Bakraci zhvilluam kete aktivitet te bukur per rendesine e familjes ne shoqerine tone	15.05.2025
12	Dita nderkombetare e Muzeut	Aktivitet ne Qendren Multi-profesionale per nder te kesaj dite se bashku me nxenesit e klasave te para nga sh.f.m.u Lidhja e Pejes	18.05.2025
13	Dita boterore kunder pirjes se duhanit	Se bashku me femijet organizuum aktivitet rreth vetdijesimit te tyre per rreziket qe vijne nga pirja e duhanit	31.05.2025
14	1 Qershori	Dita e bukur e femijeve	31.05.2025

SHTEPIA E KULTURES VITOMIRICE			
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Literarni Cas i dodela knjiga za Najbolje citaoce	Povodom Dana Nezavisnosti Kosova,Odrzan je Literarni cas u Biblioteci 14.02.2025 Literarni Cas je Oranizovao Dom Kulture sa uenicima osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave ucestvovalo je 40 ucenika i Nastavnika .Proglaseni su najbolji i Dodijeljene su knjige za najbolje Citaoce u 2024 godini.	14.02.2025
2	Izložba Knjiga	Odrzana je Izlozba najnovih izdanja knjiga na Albanski i Bosanski jezik .Izlozba je odrzana u Biblioteci 15.04.2025 .Na Izlozbi su posjetili ucenici osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave 60 ucenika i Nastavnika je obislo Izlozbu.	15.04.2025

3	Sastanak sa Komitetom za Zajednice SO Pec	Odrzan sastanak sa Predstavnicima Komitetaza Zajednice SO Peci i NVO iz Vitomirice .Na Sastanku su izlozeni problemi u Domu Kulture u Vitomirici .Predstavnici Komiteta su obekali da ce Pomoci za Bolji rad Doma Kulture u narednom periodu	22.04.2025
4	Sportske Igre	Povodom Dana Oslobodjenja Peci a,Odrzane su Sportske Igre "Vitimirica 2025 Takmicenje je odrzano 15.06.2025 u Atletici. Ucestvovala su skole iz Vitomirice,Peci,Banje Dobruse,Zlopeka,Novog Sela i Ozdrima.Specijalni gosti su bili iz Prizrena Ucestvovalo je preko 150 Ucenika .Najbolja Ekipa je bila iz Vitomirice Druga iz Dobruse trci iz Peci .Najbolja tri ucenika u svakoj Disciplini su Dodijeljene Medalje i Diplome a Pehari najboljim skolama .	15.06.2025

Galerinë e Arteve – Pejë			
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Ekspozitë	Ekspozite Keep calm and smile nga Korab Basha	20 Janar
2	Ekspozitë	Ekspozita kolektive e artistëve nga Shkodra, “Prap do t’ia nisim prej diellit”, të cilë u bashkuan në Pejë gjatë aktiviteteve të 17 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës	17 Shkurt
3	Ekspozitë	Ekspozita 'Profile Dardane' e Prof. Isa Alimusajt	5 Prill
4	Ekspozitë	Ekspozita 'Mos më thuaj Gru...' e autores Ardita Rizvanolli	5 Maj
5	Ekspozitë	Ekspozita retrospektive e një nga grafistëve më të shquar shqiptarë Fatmir Krypës	12 Maj
6	Ekspozitë	Ekspozita Perpjekja e Arte me kurator Berat Bajrami, rrugetimi I xhudos ne lartesine e Kosoves	09 Qershor

SHTEPIA E KULTURES VITOMIRICE			
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Literarni Cas i dodela knjiga za Najbolje citaoce	Povodom Dana Nezavisnosti Kosova,Odrzan je Literarni cas u Biblioteci 14.02.2025 Literarni Cas je Oranizovao Dom Kulture sa uenicima osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave ucestvovalo je 40 ucenika i Nastavnika .Proglaseni su najbolji i Dodijeljene su knjige za najbolje Citaoce u 2024 godini.	14.02.2025
2	Izložba Knjiga	Odrzana je Izlozba najnovih izdanja knjiga na Albanski i Bosanski jezik .Izlozba je odrzana u Biblioteci 15.04.2025 .Na Izlozbi su posjetili ucenici osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave 60 ucenika i Nastavnika je obislo Izlozbu.	15.04.2025
3	Sastanak sa Komitetom za Zajednice SO Pec	Odrzan sastanak sa Predstavnicima Komitetaza Zajednice SO Peci i NVO iz Vitimirice .Na Sastanku su izlozeni problemi u Domu Kulture u Vitimirici .Predstavnici Komiteta su obekali da ce Pomoci za Bolji rad Doma Kulture u narednom periodu	22.04.2025
4	Sportske Igre	Povodom Dana Oslobodjenja Peci a,Odrzane su Sportske Igre "Vitimirica 2025 Takmicenje je odrzano 15.06.2025 u Atletici. Ucestvovale su skole iz Vitimirice,Peci,Banje Dobruse,Zlopeka,Novog Sela i Ozdrima.Specijalni gosti su bili iz Prizrena Ucestvovalo je preko 150 Ucenika .Najbolja Ekipa je bila iz Vitimirice Druga iz Dobruse trci iz Peci .Najbolja tri ucenika u svakoj Disciplini su Dodijeljene Medalje i Diplome a Pehari najboljim skolama .	15.06.2025

Shfytëzimi I hapesirave te institucioneve sportive nga klubet			
Nr.	Institucioni	Klubi Shfrytëzues	Orari javor i shfrytëzimit
1	Stadiumi Vitomiricë	K.F. Behar	12 orë
2	Stadiumi Vitomiricë	K.F. Behar	2 orë
3	Stadiumi Vitomiricë	K.F. Rilindja 1974	12 orë
4	Stadiumi Vitomiricë	K.F. Istogu	2 orë
5	Stadiumi Vitomiricë	K.F.F. Behar	6 orë
6	Sta.i "Shahin Haxhiislami	K.F. Rilindja 1974	12 orë

7	Sta. "Shahin Haxhiislami"	K.A. Peja	10 orë
8	Sta. Tahir Vokshi	K.F. Besa	12 orë
9	Sta. " Shahin Haxhiislami"	k.F Peja	6 orë
10	Sta. tahir Vokshi	K.F. Arena	6 orë
11	Sta. Tahir Vokshi	K.F Shkendija	6 ore
12	Sta. Tahir Vokshi	K.F. AS Peja	4 ore
13	Sta. Novosellë	K.F. Drini I Bardhë	6 ore
14	Sta. Novosellë	K.F. AS Peja	6 ore
15	Sta. Novosellë	K.F.Shqiponja	20 ore
16	Sta. Novosellë	K.F.Arena	2 ore
17	Sta. Novosellë	K.F. Koci	2 ore
18	Palestra Karagag	K.B. Peja	10 ore
19	Palestra Karagag	K.H. Besa Famgas	10 ore
20	Palestra Karagag	K.V.Peja	12 ore
21	Palestra Karagag	K.Box Peja	10 ore
22	Palestra Karagag	Sporti Shkollor	100 ore
23	Salla Partizani	K.K. Peja	6 ore
24	Salla Partizani	K.K. Arena	6 ore
25	Salla Partizani	K.K. Ipon	6 ore



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORIA KOMUNALE PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

PËR/ZA/TO:	z.Gazmend Muahxheri - Kryetar I Komunës së Pejës
DATA/DATE	24/07/2025
NGA/OD/FROM:	z.Gëzim Gashi – Drejtor I DKMSH-se
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Punës per 6 mujorin e vitit 2025

I nderuar z.Kryetar

DKMSH-ja, gjatë periudhës 6 mujore te vitit2025 ka pasur shumë detyra, obligime dhe përgjegjësi të cilat konsiderojmë se i kemi kryer me sukses.

Dinamika e punëve ne DKMSH e përshkruar me pakë fjalë, në përgjithësi ka qenë mirë e organizuar, dhe me detyra e përgjegjësi të ndara, sipas planit dinamik te DKMSH për vitin 2025, në atë mënyrë që gjithsecili të kryej me sukses obligimet dhe detyrat për të cilat është i thirrur.

DKMSH ka bashkërendit aktivitetet me te gjitha institucionet tjera relevante sidomos me policinë e Kosovës stacionin policor- Pejë për tu ballafaquar me sukses në të gjitha rastet e krijuara emergjente, gjithashtu DKMSH është nikoqire dhe organizatore e punës së komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve ku gjithashtu 2 zyrtar të kësaj drejtorie janë pjesë e këtij komisioni me pozicionin e kryesuesit dhe sekretarit ku punët nga kjo drejtori vazhdojnë qe nga pranimi i kërkesave nga qytetaret e gjer te epilogu përfundimtar për ndonjë kompensim të mundshëm nga niveli qendror(qeveritar).

Kërkesat e parashtruara nga qytetaret pran DKMSH-së ,në këtë periudhë gjashtë mujore janë trajtuar në kohë reale dhe pritët të adresohen ne kuvend për miratim ne seancën e radhës te mundshme.

Gjatë kësaj periudhe janë parashtruar 52 kërkesa administrative për DKMSH, prej te cilave 43 janë në proces e sipër, te aprovuara janë 9.

Sipas radhës po ju prezantojmë shërbimet dhe aktivitet të NJ.P.Z.SH, Preventiva nga zjarri dhe te fatkeqësive natyrore etj.

JU njoftojmë sipas radhës për intervenimet e Nj. P. Z . SH sipas tabelës në vijim ku njësia është obliguar të dal në intervenim dhe konsiderojmë se çdo thirrje për intervenim nga momenti që është marrë informacioni, gatishmëria e reagimit ka qenë shumë e shpejtë.

Njësia Profesionale e Zjarre fikjes dhe Shpëtimit brenda Gjashtë Mujorit te vitit ka pasur rreth **194 intervenime** të natyrave të ndryshme, prej tyre 146 intervenime zjarri, 32 intervenime teknike dhe 12 shërbime te ndryshme.

Duke u mbështetur në: Ligjin për zjarrfikës dhe shpëtim, Ligjit për mbrojtje nga zjarri, Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të aprovuar nga Parlamenti i Kosovës, si dhe Udhëzimi administrativ për hartimin e planeve periodike, NJPZSH ka bërë hartimin e planit vjetor, dhe raporteve periodike për realizimin e detyrave të përcaktuara me këto ligje.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interv~~en~~**en, struktura e zjarreve dhe int.tjera Janar- Qershor të vitit 2025**

	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rrejsh	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
2024													
Janar	27	18	7	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	46	37	6	2	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Mars	26	18	6	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	38	34	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	27	17	7	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	27	22	4	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik													
Gusht													
Shtator													
Tetor													
Nëntor													
Dhjetor													
Gjithsejtë	191	146	32	12	0	0	1	0	0	0	0	0	0

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2025														
	LIOJI I INTERVENIMIT	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qersh	Korr.	Gush.	Shta	Tet.	Nënt.	Dhje.	GITHËSEJ.
1	ZJARRË	18	37	18	34	17	22							
2	INTERVENIME TEKNIKE	7	6	6	2	7	4							
3	SHËRBIME	2	2	2	2	3	1							
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI	0	0	0	0	0	0							
5	VËRSHIME	0	0	0	0	0	0							
6	ALARME TË RREJSHME	0	1	0	0	0	0							
	Gjithësejtë:	27	46	26	38	27	27							
1. Ndarja analitike e zjarreve në : OBJEKTE NDËRTIMORE														
1.1	Banesa – shtëpi	2	1	0	1	3	1							
1.2	Objekte ndimëse	0	0	0	0	0	0							
1.3	Plevica - shtalla	0	0	2	1	0	0							
1.4	Objekte kolektive (banesa)	0	0	0	0	0	0							
1.5	Oxhaqe	5	2	0	2	0	0							
1.6	Të tjera	0	0	2	0	1	0							
	Gjithësejtë:	7	3	4	4	4	1							
2.1	Publike	0	0	0	0	0	0							
2.2	Objekte Biznesi	0	0	0	0	1	0							
2.3	Objekte Indusiale	0	0	0	0	0	0							
2.4	Të tjera	0	1	0	1	0	0							
	Gjithësejtë:	0	1	0	1	1	0							
3.1	Paisjet elektrike / trafo	1	1	0	0	0	0							
3.2	Paisjet shpërndarëse	1	2	0	0	2	0							
3.3	Gjenerator	0	0	0	0	0	0							
3.4	Të tjera	2	3	2	0	2	1							
	Gjithësejtë:	4	6	2	0	4	1							

4. Ndarja analitike e zjarreve në:		SIPËRFAQE TË HAPURA												
4.1	Mal	0	7	5	12	0	0							
4.2	Sipërfaqja e djegur (hektar)	0	2.5 hek	5 (hek)	7 (hek)	0	0							
4.3	Bari i thatë	0	18	5	5	0	10							
4.4	Sipërfaqja e djegur (hektar)	0	3.5 hek	7 (hek)	6.5 hek	0	3.5 hek							
4.5	Sipërfaqe bujqësore	0	0	0	0	0	0							
4.6	Sipërfaqja e djegur (hektar)	0	0	0	0	0	0							
4.7	Të tjera	6	1	1	11	6	9							
5. Ndarja analitike e zjarreve në:		AUTOMJETE TRANSPORTIO												
5.1	Automjete motorrike	1	1	1	1	2	1							
	Gjithësejtë:	1	1	1	1	2	0							
6. Ndarja analitike:		INTERVENIMEVE TEKNIKE												
6.1	INTERVENIME TEKNIKE	7	6	6	2	7	4							
6.2	SHËRBIME	2	2	2	2	3	1							
6.3	AKSIDENTE RRUGORE	0	0	0	0	0	0							
6.4	VËRRSHIME	0	0	0	0	0	0							
7. Të lënduar														
7.1	Zjarrfikës	0	0	0	0	0	0							
7.2	Qytetarë	0	0	0	0	0	0							
	Gjithësejtë:	0	0	0	0	0	0							
8. Të vdekur														
8.1	Zjarrfikës	0	0	0	0	0	0							
8.2	Qytetarë	0	0	0	0	0	0							
	Gjithësejtë:	0	0	0	0	0	0							
9. Prona:														
9.1	Shoqërore	0	0	0	0	0	0							
9.2	Private	0	0	0	0	0	0							
10. Pjesëmarrja e zjarrfikësve:														
10.1	Zjarrfikësa aktiv	95	153	73	122	38	89							

10.2	Zjarrfikësa vullnetar	0	0	26	0	0	0							
11. Mjetet e përdorura:														
11.1	Komanduese	6	7	9	10	7	6							
11.2	Sulmuese	27	43	24	38	27	4							
11.3	Tanker	4	6	2	8	6	3							
11.4	Teknike	3	2	2	3	3	0							
11.5	Transportuese	0	0	2	0	2	0							
11.6	Emergjente	0	0	0	0	0	0							
12. Mjete të shpenzuara:														
12. 1	Ujë / m ³	1160 11	955 0	15800	54500	34500	27900							27
12. 2	Shkumë / lit.	15 L	10 l	30 l	30 l	20 L	0							
12. 3	Pluhur / kg.	3 S9	2 S9 1 S6	3 S9 1 S6	3 S9 1 S6	4 S9	2 S9							
12. 4	CO2 / kg	0	0	0	0	0	0							
12. 5	Mjete tjera	4 thas byk	0	0	4 thas byk	0	4 thas byk							
13. Orë pune:														
13. 1.	Orë pune	20	15	44	65	28	20							
13. 2	Minuta	33	10	08	05	15	33							
	GJITHËSEJTË:	20:33	15:10	44.08	65:00	28:15	30:33							

Pasqyra e numrit të përgjithshëm të zjarreve për periudhën raportuese:

	Zjarrë në Objekte ndërtimore						Zjarrë në Objekte ekonomike				Zjarrë në Pajisje elektrike				Zjarrë në Sipërfaqe të hapura				Zjarrë në Autom.	Gjith.
	Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera - kulmi	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike trafo	Pajisjet shpërndarëse	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera	Automjete motorrike	
2025																				
Janar	2	0	0	0	5	0	0	0	0	0	1	1	0	2	0	2	0	4	1	18
Shkurt	1	0	0	0	2	0	0	0	0	1	1	2	0	3	7	18	0	1	1	37
Mars	0	0	2	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	2	5	5	0	1	1	18
Prill	1	0	1	0	2	0	0	0	0	1	0	0	0	0	12	5	0	11	1	34
Maj	3	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	2	0	2	0	0	0	6	2	17
Qershor	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	10	0	9	1	22
Korrik																				
Gusht																				
Shtator																				
Tetor																				
Nëntor																				
Dhjetor																				
Gjithsejtë	8	0	3	0	9	3	0	1	0	2	2	5	0	10	24	40	0	32	1	146

Nr.	Detyrat e realizuara	Gjithsejtë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
1.	Zjarret	139	17	37	19	28	15	
	Raportet e zjarreve	29	3	5	4	11	4	
2.	Inspektimet e rregullta dhe fillestare	31	5	7	6	4	6	
	Nr. te metat dhe mangësitë	158	25	35	32	23	28	
	Insp. në pronësi shtetërore	14	4	2	3	-	3	
	Insp. në pronësi private	17	1	5	3	4	3	
	Numri i objekteve	37	5	7	8	5	8	
	Kategorizimi – Kateg. I	-	-	-	-	-	-	
	- Kateg. II	5	-	2	-	1	2	
	- Kateg. III	32	5	5	8	4	6	
	- Kateg. IV							
3.	Inspektime te jashtëzakonshme	3	-	1	1	1	-	
	Nr. te metat dhe mangësitë	5	-	1	3	1	-	
	Insp. në pronësi shtetërore		-	-	-	-	-	
	Insp. në pronësi private	3	-	1	1	1	-	
	Numri i objekteve	3	-	1	1	1	-	
	Kategorizimi – Kateg I		-	-	-	-	-	
	- Kateg II		-	-	-	-	-	
	- Kateg III	3	-	1	1	1	-	
	- Kateg IV							

4.	Vendime ne inspektime te rregullta dhe fillestare	30	7	5	4	5	6	
	Masat e shqiptuara	166	37	38	17	29	31	
5.	Inspektime verifikuese	31	6	7	5	5	8	
	Masa te konstatuara	142	32	26	23	25	36	
	Masa te realizuara	33	8	16	4	3	2	
	Jo te kryera	90	23	2	16	20	29	
	Ne faze te kryerjes	19	1	8	3	2	5	
6.	Gjithsejtë inspektime	62	11	14	11	9	14	
7.	Pëlqime ne dok. inv. tek.	10	2	-	-	5	3	
	Ndërtime te reja	10	2	-	-	5	3	
	Legalizim i obj. te ndërtuara	-	-	-	-	-	-	
	Ndërrim i destinim. te objek.	-	-	-	-	-	-	
8.	Proces ne dok. Inv. ek.	10	2	-	-	5	3	
9.	Pëlqime ne lokacion	-	-	-	-	-	-	
10.	Pëlqime ne Rregullore te mbrojtjes nga zjarri	-	-	-	-	-	-	
11.	Vërtetime	2	-	1	1	-	-	
12.	Raporte pune – mujore , gjashtë mujore dhe vjetore	9	2	1	2	1	1	
13.	Plane pune – mujore, gjashtëmujore dhe vjetore	7	1	1	1	1	1	
14.	Inspektime te korrje shirjeve dhe maleve	-	-	-	-	-	-	

15.	Proces verbale mbi pranimet teknike	-	-	-	-	-	-	
16.	Njoftime	-	-	-	-	-	-	

- Gjatë periudhës në fjalë kam realizuar këto detyra.

Për këtë periudhë 6 mujore te vitit 2025 kam qen pjesë e organizimit dhe administrimit më sektorët e DKMSH sipas instruksioneve administrative e te direktivave operative për çfarëdo çështjeje që ka të bëjë më funksionet dhe përgjegjësit e DKMSH-së.

Kam realizuar intervenime-operime emergjente në bashkëpunim me drejtorit komunale, dhe strukturat emergjente komunale, si dhe ministrit; Ministria e infrastrukturës, Ministria e Ekonomisë më zyrtarin e Gjeologjisë Inxhinierike, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.

Për këtë periudhë 6 mujore të vitit 2025 në komunën e Pejës më rrethinë janë monitoruar rastet e identifikuara të rrëshqitjes së dheut dhe gurëve te cilat janë identifikua në vitet e kaluara, mirëpo për fat te mirë për ketë periudhë 6 mujore te vitit 2025 nga këto raste te identifikuara nuk kemi pasur raste të fatkeqësisë së kësaj natyre te rrëshqitjeve te dheut dhe gurëve, duke patar parasysh se janë marr edhe masa parandaluese nga Komuna.

Po ashtu për këtë periudhë 6 mujore te vitit 2025 janë identifikuar disa raste në fshatra te cilat kanë mungesë te ujit të pijshëm.

Raportet e inspektimeve për periudhën në vijim;

- Për këtë periudhë 6 mujore, të gjitha Kërkesat e parashtruara nga qytetarët pran DKMSH, qe kanë pasur të bëjnë më parandalim të rrezikshmërisë, zvogëlim të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, janë inspektuar.

- Janë realizuar disa inspektime të rregullta, te cilat po ashtu kanë të bëjnë më zvogëlim të rreziqeve.
- Në fushën e inspektimit të objekteve, në lëmin për mbrojtje dhe shpëtimit nga zjarri, janë realizuar inspektime fillestare dhe të rregullta.
Inspektimet janë realizuar në sektorin publik dhe Individual (privat) për objektet e rëndësisë së veçantë sipas kategorive, dhe se janë nxjerr;
Procesverbali,
Propozimi i masave dhe afateve,
Vendimet te nxjerr- ura duke u bazuar në ligjet për vetëqeverisje lokale, ligjit për mbrojtje nga zjarri, dhe ligjit për procedurën administrative.
Procesverbali i inspektimit verifikues.

Përmbledhja e përgjithshme e kërkesave të shqyrtuara dhe numri i lëndëve të realizuara

Nr.	EMERTIMI I LËNDËS	
1	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TEREN	02
	NUMRI I KERKESAVE PËR VLERSIM DËMI NGA VERSHIMET, ERA.	02
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	02
	NUMRI I LËNDEVE TË PA REALIZUARA	0
2	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TEREN	04
	VLERSIM RREZIKU NGA FATKEQESIA NATYRORE “ ERA”	04
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	04
	NUMRI I LËNDEVE TË PA REALIZUARA	0
3	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TEREN	04
	VLERSIM RREZIKU NGA FATKEQESIA NATYRORE “ ERA”	02
	VLERSIMI I RREZIKUT NGA FATKEQESIA NATYRORE RRESHQITJA E DHEUT.	02
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	04
	NUMRI I LËNDEVE TË PA REALIZUARA	00
4	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TEREN	03

	VLESIMI I RREZIKUT NGA ZJARRI FUSHOR	01
	VLERSIMI I RREZIKUT NGA OBJEKTI I VJTERSUAR DHE DEMOLUAR	01
	REKOMANDIM DREJTORIS SHERBIMEVE TEKNIKE PER KANALIN , “ BEHOCIT”.	01
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	03
	NUMRI I LËNDEVE TË PA REALIZUARA	00
5	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TEREN	02
	VLERSIM RREZIKU NGA NDOTJA E UJIT TE PISHEM	01
	VLERSIMI I RREZIKUT NGA RROKULLISJA E “ GURIT”	01
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	02
	NUMRI I LËNDEVE TË PA REALIZUARA	00
6	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TEREN	02
	VLERSIMI I RREZIKUT NGA MUNGESA E UJIT TE PISHEM, FSHATIN DUSHKAJ	01
	VLERSIM RREZIKU NGA ZJARRI FUSHOR	01
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	02
	NUMRI I LËNDEVE TË PA REALIZUARA	0
Totali	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TEREN	19
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	19
	NUMRI I LËNDEVE TË PA REALIZUARA	0



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ
DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE
Directorate of Social Welfare
Direktorijat za Socijalnu Zaštitu

Raport i Punës janar-qershor '2025

Pejë, korrik '2025

REFERENCA :	Raport i Punës
Datë/Datum/Date	Qershor 2025
PËR/ZA/TO	Z. Gazmend Muhaxheri - Kryetar i Komunës së Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Albulena Mujaj Bjraktaraj - Drejtoreshë e Mirëqenies Sociale
NGA/OD/FROM	Drejtoria Për Mirëqenie Sociale-Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	RAPORTI I PUNËS / JANAR – QERSHOR 2025

RAPORT I PUNËS JANAR - QERSHOR ‘2025

Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria për Mirëqenie Sociale ka realizuar aktivitetet e listuara si më poshtë:

AKTIVITETET E DREJTORISË

- Dyqind (200) familje me asistencë sociale janë ndihmuar me nga dy(2) metra lende drusore.
- Është hapur thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve me karakter social , nga e cila thirrje Komisioni Vlerësues ka vlerësuar projektet te cilat i kane plotësuar kriteret e thirrjes.
Nga kjo thirrje janë përkrahur gjithsejtë nente (9) OJQ me karakter social:
- **Duart plote Mëshirë** - “ Shërbime psiko-sociale per fëmijë me ngecje ne zhvillim dhe te moshuarve dhe te sëmurëve pa përkujdesje adekuate”
- **Qendra për Mirëqenin e Gruas-Pejë** - “Shërbime rezidenciale dhe ri integruese për gra dhe fëmijë”
- **Qendra për Jete te Pavarur** - “Shërbime cilësore sociale për personat me aftësi te kufizuar mendore ne Komunën e Pejës”
- **Qendra e Kujdesit Ditor Pema** - “Fuqizimi i programeve mbeshtetese per femijet me aftesi te kufizuara ne komunën e Pejës”
- **Asociacioni te Semuarve nga Diabeti ne Peje-ASDP-** “Si te pergjigjemi nevojave gjithnje e ne rritje te menaxhimit te problemeve diabetike te qytetareve te komunes se Pejës me theks te vecante femijeve me diabet
- **Handikos Pejë** - “Sherbime ditore dhe ne familje per femijet dhe te rriturit me aftesi te kufizuar”
- **SHHBK “Nëna Terezë”** Sherbime sociale dhe perkujdesje per te moshuar
- **OJQ “Princesha”** Sherbime ditore te drejperdrejta dhe asistence materiale per personat e moshuar dhe pa perkujdesje familjare ne Komunën e Pejës
- **OJQ për Fëmijët pa Kujdes Prindëror (OFAP)** -Mbeshtetja dhe zhvillimi i sherbimit te strehimit familjar ne komune te Pejës

KRIJIMI I INFRASTRUKTURES SE RE

- Objekti "ShtëpiA Emergjente 2" është në fazën përfundimtare të realizimit.

RAPORT VJETOR I PUNËS SE QENDRES PËR PUNË SOCIALE Janar-Qershor 2025

SHËRBIMI SOCIAL

Qendra për Punë Sociale në Pejë, gjegjësisht Sektori i Shërbimeve Sociale për gjatë muajit të parë janar-mars 2025 ka kryer punët dhe detyrat në kompetencat që ka si Institucion, dhe është angazhuar në realizimin e detyrave dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Ligji mbi Familjen në Kosovë si dhe nga Legjislacioni në fuqi.

Shërbimi Social pranë Qendrës për Punë Sociale në Pejë për këtë periudhë kohore ka evidentuar në protokollin e Shërbimeve Sociale 761 shërbime, prej të cilave 116 janë dosje. Dosjet që janë kryer janë 100 dhe 25 janë në përpunim. Gjithashtu kemi 11 Certifikata për shlyerje të shtetësisë, 430 Certifikata për armë dhe 220 Certifikata për zotësi të veprimit (për punësim).

Bazuar në evidencën për lëndët e hapura e që kanë hyrë në përpunim, sipas kategorive të shërbimit social ju raportojmë në vazhdim:

- 1. Kërkesa për këshilla martesore:** Në këtë periudhë kohore kemi 1 kërkesa për këshillime martesore, Ndarje me padi 26, Ndarje me marrëveshje janë 22, Padi për besim të fëmijëve 2.
37 Lënda janë përfunduar dhe Raportet janë dërguar në Gjykatë, ndërsa 13 Lëndë janë në Procedurë.
- 2. Kontaktim mes prindit dhe fëmijës:** Në këtë periudhë kohore kemi 5 kërkesë për kontaktim. Në këtë lëmi kemi edhe 12 lëndë që janë aktive, ku realizohet kontaktimi në mes prindit dhe fëmijëve në lokalet e QPS.

3. Kërkesë për adoptim vendor: Në këtë periudhë kohore nuk kemi pasur kërkesë për adoptim vendor 1 kërkesë.

4. Fëmijët pa përkujdesje prindërore: Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pranuar kërkesa.

5. Strehim për të moshuar: Në këtë periudhë kohore nuk kemi pasur kërkesë për strehim të moshuarve.

6. Trafikim: Nga kjo lami gjatë kësaj periudhe kohore nuk pasur ndonjë rast të referuar për ofrim të shërbimeve psiko-sociale.

7. Sjelljet asociale / delikuate: Në këtë periudhë kohore kemi 37 lëndë të fëmijëve me sjellje asociale dhe delikuate ku prej tyre 38 lëndë janë delikuate/kundërvajtje dhe 3 lëndë me sjellje asociale (braktisje nga shkolla). Nga këto kategori kemi edhe 17 lëndë që janë nën mbikëqyrje të Organit të Kujdestarisë në periudha kohore prej 6 muaj deri në 1 vit.

8. Dhuna familjare dhe ngacmimi seksual: Në këtë periudhë kohore kemi 25 raste të dhunës në familje dhe 1 ngacmime seksuale. Aktive në këtë kategori kemi 15 lëndë ndërsa 10 kanë përfunduar, gjithashtu në këtë periudhë kemi edhe 10 Aktgjykime për urdhër mbrojtje të lëshuar nga Gjykata Themelore.

9. Kujdestaria e posaçme/përhershme: Në këtë periudhë kohore kemi 15 raste të caktimit dhe ndryshimit të kujdestareve për fëmijë dhe të moshuar. Në këtë kategori në kujdestari kemi 86 fëmijë dhe 11 raste të kujdestarisë të personat e rritur që të gjitha këto lëndë janë aktive.

10. Heqja e të drejtës prindërore: Në këtë periudhë kohore nuk kemi asnjë kërkesë nga Gjykata për heqjen e të drejtës prindërore.

11. Heqja e zotësisë së veprimit: 0 Lëndë në procedurë për heqje të zotësisë së veprimit.

14. Konstatim të gjendjes faktike: Gjatë kësaj periudhe kohore, kemi 13 kërkesa për konstatim të gjendjes faktike, të 13 rasteve iu është ofruar shërbimi.

15. Pëlqim për martesë para moshës madhore: Në këtë periudhë kohore kemi pasur 1 kërkesë për dhënie të mendimit për martesë para moshës madhore.

16. Vendosje në strehim familjar tek të afërmit: Në këtë periudhë kohore kemi pasur 1 kërkesa, të 1 kërkesat janë proceduar me vendime dhe kontrata për pagesa mujore.

18. Fëmijët me aftësi të kufizuar: Për këtë kategori në këtë periudhë kohore i kemi të regjistruara 25 Kërkesa (aplikacione). Nga këto kërkesa 18 i janë nënshtruar komisionit mjekësor 13aprovime, 2 refuzime, 3 plotësime , 7 lëndë janë të bartura nga viti 2024 nga këto 4 janë aprovuar 2 refuzime dhe 1 mungesë
Lëndë aktive me pagesë në bazë janë gjithsejtë 151.

17. Aktvendime, Njoftime, Kërkesa, Ankesa, Fletë lëshime nga Qendrat Korrektuese:

Në këtë periudhë kohore kemi pranuar gjithsej 13 kërkesa:

Aktvendime nga Gjykata: 25

Njoftime nga Gjykata / Prokurori: 25

Kërkesa nga Institucione të ndryshme: 2

Ankesa për shkallë të dytë për A.K: 1

Proces verbal A.K: 1

Fletë Lëshime nga Qendrat Korrektuese: 0

Në data bazën e përgjithshme gjithsejtë janë të bartura 5980 lëndë.

Sherbimi i Ndhimave Sociale

Shërbimi i SNS-së në kohën raportuese Janar- Qeshor /2025 ka pasur një rrënje në kërkesa për ndihmë sociale krahasuar me periudhen e njejtë të vitit të kaluar.

Në muajin Janar kanë qenë 881 familje në Skemën e Ndhmës Sociale,Shkurt 884, Mars 859,

Në këtë periudhë kohore nga 01/01/2025 deri me 30/06/2025 janë gjetur /gjithësejtë 7 familje që kanë realizuar NS në mënyrë të jashtëligjshme (krahasim i të dhënave me ATK-në e të cilat familje menjëher largohen /nga ndihma sociale)
Prej të cilave 1 është riaktivizuar.

Kërkesat e reja: Prej dt.01/01/2025 gjerë me dt.30/06/2025 janë parashtruar 52 kërkesa për Ndhimë Sociale prej te cilave për kategorinë e I-rë 20 e për /kategorinë e II-të 15 familje.Në janar 4 kërkesa të reja kategoria e I-rë,shkurt 14 10 të kat.së I-rë e 4 kat. e II-ë dhe mars 12 kërkesa prej tyre 8 kat. e I-ë 4 Kat e II-ë

Riaplikimet:Në periudhën kohore prej dt. 01/01/2025 gjerë me dt.30/06/2025 kanë dalë në riaplikim 631 familje:Janar 100 familje,Shkurt 141 familje, Mars 108 familje,Prillë 114 Majë 87 Qeshor 81.

Verifikimi dhe Riverifikimi i familjeve:Familjet të cilat realizoin Ndhmën Sociale si dhe familjet qe paraqesin kërkesë për ndihmë sociale verifikohet në afatin kohor prej 45 ditësh.Familjet aktive të kategorisë së I-rë riverifikohen një herë në vitë kur e bëjnë riaplikimin,ndërsa familjet e kategorisë së II-të riverifikohen çdo 6 muaj kur e bëjnë riaplikimin.Janë verifikuar për herë të parë 49 familje si dhe janë riverifikuar të gjitha familjet qe kanë riaplikuar në periudhen nga Janari/2025 deri Qeshor/2025.

Aprovimet:Gjerë me dt.31/06/2025 janë aprovuar 42 familje në Ndhmë Sociale.

Refuzimet:Nga kërkesat e reja për NS janë refuzuar 7 familje.

Rishqyrtim:Në rishqyrtim janë 3 kërkesa të cilat ende nuk ju kanë nënshtruar komisionit mjekësor regional ose nuk kanë dal ende në teren për verifikim.

Ndërprerje e Ndhmave Sociale:Ndihma Sociale ju ka ndërprerë 38 familjeve për këtë periudhë e shkaku është qe nuk i plotësojnë njerin prej kriterëve të Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale ose punësim i ndonjë anëtarit të familjes,përmirësim i gjendje ekonomike të familjes,shkuarje në boten e jashtme si dhe mbushin moshën 65 vjeqare dhe kalojn në PB etj.

Komisioni mjekësor:Në këtë periudhë kohore janë mbajrt 6 seanca të komisionit mjekësor në nivelin regjional janë shqyrtuar 682 aplikacione të komisionit mjekësor dhe prej tyre në Janar 176,Shkurt 264,Marse 242.

Në këtë periudh kohore QPS-Pejë ka pasur 176 kërkesa për shqyrtim në komisionin mjekësor regjional.Për muajin Janar ka pas 41 kërkesa ju kanë aprovuar 41, refuzuar 0 dhe plotësim 0 kërkesa.Për muajin Shkurt ka pas 99 kërkesa 95 aprovim, 1 refuzim dhe 4 plotësim.Për muajin Mars ka pas 55 kërkesa e prej tyre 55 aprovime,0 refuzime dhe 0 plotësime.

Kërkesa për rishqyrtim:Në këtë periudhë kohore janë paraqitur 1 kërkesa për rishqyrtim e prej tyre 1 kërkesë është aprovuar.

Shkalla e II-të e ankesave DPSF:Në këtë periudhë nuk kemi ankesa prej tyre

Ankesa për Gjykatën Themelore:Kemi 0 ankesë.

Ndihma e njëhershme (Emergjente):Në këtë periudh kohore prej 01/01/2025deri me dt.30/06/2025 nuk kemi pasë kërkesa për ndihmë të njëhershme.

Çertifikata për student:Nuk ka pas.

Çertifikata:Nga ky sherbim janë leshuar 87 çertifikata për shfrytëzuesit e NS si dhe për ata që nuk realizojn NS ose për marjen e Shtetësisë në Republikën e Kosovës etj.

1.Zyrtarët e Sherbimit të Asistences Sociale në muajin Mars kanë përpiluar listat për 150 familje për pako ushqimore për muajin e Ramazanit nga organizata Cherity .

2.Zyrtarët e Sherbimit të Asistencës Sociale në muajin Ramazanit kanë përpiluar listat për 70 familje të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës sociale nga donatorët individual me pako ushqimore .

Shërbimi i asistencës sociale është i kyqur edhe në punën e SAS- Pilot Projekt program nga niveli qendror bazuar në aplikimet online për muajin Janar ka ardhë lista me 119 familje të cilat janë vizituar në teren kurse për muajin Mars ka ardh lista me 12 familje prille 12 Qeshor jemi ne pritje.

Albulena Mujaj-Bajraktaraj
Drejtorja për Mirëqenie Sociale



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

**RAPORTI GJASHTË-MUJOR I DREJTORISË PËR PUNË INSPEKTUESE
PËR VITIN 2025**

Qershor, 2025

Raporti i hartuar është bazuar dhe mbështetur në kompetencat ligjore dhe përshkrimin të punës si dhe në zbatimin e Planit të Veprimit për Vitin 2025.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE (DPI)

Objektivat

- **Angazhimi maksimal për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të cilat i kemi si Drejtori brenda kuadrit të kompetencave ligjore .**
- **Kryerja e punëve inspektuese konform ligjeve në fuqi.**
- **Bashkëpunimi me organet e rendit dhe sigurisë në rastet kur duhet të intervenojmë dhe paraqitet rrezikshmëria.**
- **Rritja e transparencës.**

DPI është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve komunale në lëmin e:

- a) Inspektoratit Komunal të Tregut dhe Komunikacionit; b) Inspektoriatit Komunal; c) Inspektoratit Komunal të Ndërtimit; dhe d) Inspektoratit Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit.

ORGANIZIMI I DREJTORISË PËR PUNË INSPEKTUESE

1. Sektori i Tregut dhe Komunikacionit në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal të Tregut dhe Komunikacionit.
2. Sektori Komunal në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal.
3. Sektori i Ndërtimit në kuadër të së cilit ka vepruar Inspektori Komunal i Ndërtimit.
4. Sektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Mjedisit në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit.

Planet e Veprimit planifikohen në fillim të vitit kalendarik për secilin Sektor përkatës dhe organizohen aktivitete (plane operative) në bazë të periudhave sezonale, ankesave dhe kërkesave të qytetarëve gjithmonë me të vetmin qëllim që të zgjedhim problemet e qytetarëve, të jemi pranë tyre dhe të evitojmë pengesat ligjore duke ndërmarrur masat e nevojshme në kuadër të kompetencave Ligjore.

1. Sektori i Tregut dhe Komunikacionit

Udhëheqës i Sektorit të Tregut dhe Komunikacionit:

Haxhi Gashi

Inspektorët Komunal të Tregut: Agim Nikqi, Berat Smajli, Duresa Bytyqi, Dorentina Berisha, Elinda Pilingjurka, Sali Kelmendi, Xhevahire Çeku-Kelmendi.

Gjatë periudhës gjashtëmuor Inspektorët e Tregut kanë realizuar disa nga objektivat nga Plani i Veprimit për vitin 2025 bazuar në kompetencat të cilat ju takojnë në kuadër të ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, si dhe punë të tjera të cilat janë caktuar nga shefi i Sektorit dhe Drejtoresha e Drejtorisë për Punë Inspektuese.

Bazuar në përshkrim të detyave të punës dhe kompetencave që u ngarkohen këto janë ligjet dhe aktet nënligjore me të cilat operojnë Inspektorët Komunal të Tregut të cilat janë të kufizuara në disa raste të caktuara.

1. Ligji mbi Mbrojtjen e Konsumatorit me Nr.06/L-034
2. Ligji për Tregtinë e Brendshme Nr/ 2004/18 Ndryshim plotësimi Nr/ 04L-0053
3. Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut 03L-181 Ndryshim plotësimi 04L-186
4. Ligji për Turizmin Nr. 08L-074, sa i përketë këtij ligji kemi dal për kategorizimin e Hoteleve dhe Moteleve në bazë të urdhëresave nga MINT- (Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë).
5. Ligji për punimet nga metalet e çmuara Nr/ 04L-154 në këtë ligj kemi marur pjesë si ekip plotësues (asistim) me Inspektorët e Tregut të nivelit qendror.
6. Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr/ 03/2022 për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburantve të ripërtëritshme dhe masat e tjera mbrojtëse.
7. Ligji Nr.08/L-172 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
8. Ligji Nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësim të Konformitetit, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
9. Ligji Nr.2004/44 për Zejtari.
10. Ligji Nr.08/L-205 për Të drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
11. Ligji Nr.08/L-075 për Markat Tregtare, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
12. Ligji Nr.05/L-075 për Shërbime, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
13. Ligji Nr.04/041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
14. Ligji Nr.04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, si dhe aktet nënligjore nga ky ligj.
15. Udhëzim Administrativ (QRK) NR. 07/2023 Për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit.
16. Ligji Nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje.

Në nivel lokal (Komuna e Pejës) operojmë me Rregulloret Komunale si vijon:

- Rregullore për Plotësimin e Kushteve Minimale Teknike me Nr. 03/2023
- Rregullore për taksa Komunale Nr.02/2023
- Rregullore për Licensimin e Bizneseve për Shërbimet Alkoholike Nr. 06/2019
- Rregullore mbi Orarin e Punës për Lokalet Afariste Nr. 2000/45

Në raste të ndryshme, Inspektoriati Komunal i Tregut i përgjigjet çdoherë (MINT) sipas Ligjeve të aplikueshme duke ndërmarrur aksione të ndryshme inspektimi në kontrollet e operatorëve ekonomik në Regjionin e Pejës, gjithashtu shqyrton të gjitha kërkesat dhe ankesat që vijnë nga MINT.

AKTIVITETE INSPEKTUESE	ZBATIMI
VLERËSIME SIPAS RREGULLORES KOMUNALE (QRK) Nr.03/2023 PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE MINIMALO-TEKNIKE NË LOKALET AFARISTE TË KOMUNËS SË PEJËS	Janë pranuar zyrtarisht 70 kërkesa të palëve për tu pajisur me Pëlqime për Kushtet Minimalo- Teknike. Nga 70 kërkesa, 62 prej tyre janë shqyrtuar dhe Komisionet vlerësuese pas vlerësimit në terren kanë konstatuar se këto subjekte afariste me veprimtari të ndryshme i plotësojnë kushtet e kërkuara sipas dispozitave ligjore të Rregullores, 8 Kërkesa janë në procedurë . Tarifat përcaktohen me nenin 19.7. të RREGULLORE Nr. 01/2023 PËR TAKSAT KOMUNALE/
Kontrolla të përgjithshme në subjekte afariste të veprimtari të ndryshme si: (gastronomi, markete, barnatore, sallone të ondulimit, butiqe dhe agjencione të udhëtimit si dhe tregti të tjera). Kontrollat e përgjithshme përfshijnë inspektimet si: prezantimi i dokumentacionit, licenca të alkoolit, çmimet, çmimore, orari, emri tregtar, deklaracionet, etj;	200- Subjekte afariste janë inspektuar me procesverbale për kontrolla të përgjithshme. 18- Riinspektime 48- Subjekte afariste janë pajisur me Aktvendim për Licencë të pijeve alkoolike për vitin 2025 nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

KONTROLLA TË NDRYSHME NË BAZË TË ANKESAVE TË KONSUMATORIT (të cilat janë shqyrtuar në bazë të LIGJIT Nr. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT)	Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore janë pranuar pesë ankesa të ndryshme të konsumatorëve për pesë subjekte të ndryshme afariste dhe janë shqyrtuar duke ndërmarrur masa ndëshkimore sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT).
KONTROLLA NË BAZË TË KËRKESAVE TË POLICISË	Janë realizuar 2 kontrolla në bazë të kërkesave të Policisë në subjekte afariste (lokale) ku lidhur me dyshimin se të njëjtat ushtrojnë veprimtari ilegale. Subjektet janë inspektuar dhe ndaj tyre është inspektuar në bazë të kompetencave të Inspektoriatit të Tregut.
- Implementimi i rrjetit të SISH BHIS në të gjitha Institucionet e KPSH, si dhe ngritjen e cilësisë së futjes së dhënave në databazë.
- Punësimi i IT për mirëmbajtjen e paisjeve hardverike, softverike si dhe rrjetit të internetit.
- Mbikqyrja e disperzimit të medikamenteve nga LEB planifikimit dhe rrealizimit të planifikimit si dhe regjistrimi në SMSF.
- Racionalizimi i analizave laboratorike bazuar në diagnozë, aplikimi i termineve dhe funksionalizimi i labaratoreve në QMF.
- Aplikimi i i trendeve e reja në menaxhimin e aktiviteteve dhe personelit si implementimi i shpërblimeve por edhe dënimeve sipas legjislaciniot.



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DEPARTAMENT FOR URBANISM AND ENVIORNMENT PROTECTION
ODELENJE ZA URBANIZAM I ZAŠTITU ZIVOTNE SREDINE

Datë/Datum/Date	20.07.2025
PËR/ZA/TO	Z.Gazmend Muhaxheri / Kryetar i Komunës së Pejës
NGA/OD/FROM	Arta Nallbani – Drejtoreshë e DUMM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Raport gjashtëmujor i punës. Janar-Qershor

Gjatë kësaj periudhe kohore DUMM ka realizuar në tërësi planin e punës sipas projekteve të planifikuara dhe të listuara me poshtë sipas prioriteteve:

1. Harta Zonale e Komunës së Pejës

- HZK (Harta Zonale e Komunale) – Ka të miratuar dhe në fuqi Harten Zonale Komunale 2023-2031

2.PROCESI I LEGALIZIMIT TE NDËRTIMEVE PA LEJE

Më datë 01.09.2023 ka filluar afati i ri për aplikimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje pas ndryshim/plotësimit të Ligjit për trajtimin e objekteve pa leje, Ligji me nr 08/L-184. Afati për aplikim është deri me datën 31 Dhjetor 2025.

KERKESAT E PARAQITURA NË DUUM SIPAS KATEGORISË

Lloji i Kërkesës :	Numri i kërkesave:
Leje të lëshuara të Ndërtimit	125
Kushte ndërtimore	120 të përfunduara Të tjera në proces
Leje Komunale Mjedisore	10
Legalizime	65 kërkesa

TE HYRAT NGA LEJET NDËRTIMORE, MJEDISORE DHE LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2023 ËSHTË: TOTAL: 204,015.25€
Legalizime: 2,691.89

RAPORT 6 (GJASHTË) MUJOR I PUNËS

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – Komuna e Pejës

Periudha raportuese: Janar- Qershor 2025

Paraqitet në Kuvendin Komunal të Pejës.

1. Hyrje

Në përputhje me obligimet ligjore dhe administrative, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik paraqet raportin 6 (Gjashtë) mujor të punës për periudhën Janar–Qershor 2025.

Ky raport përfshin një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara, aritjeve kryesore, sfidave të hasura dhe rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm të punës dhe performancës në këtë sektor.

2. Fusha e Veprimit dhe Objektivat Strategjike.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka për mision nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Komunën e Pejës, përmes krijimit të kushteve të favorshme për bizneset, përkrahjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillimit të turizmit dhe tërheqjes së investimeve.

Objektivat strategjike gjatë periudhës raportuese kanë qenë:

- **Nxitja e ndërmarrësisë përmes përkrahjes së start-up bizneseve;**
- **Promovimi i potencialit turistik të komunës;**
- **Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për ekonomi dhe turizëm;**
- **Bashkëpunimi me sektorin privat dhe organizatat zhvillimore**

Fillimi I ndertimit te muzeut te Bjeshkatarisë(Gjeravica)

Fillimi I ndertimit te Zip Line „ LIPA „ në Bjeshken e Lipës.

Pejë, Qershor 2025

Nasret Hajrizi-Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.



Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

Raporti Gjashtëmujor
Janar-Qershor 2025

KORRIK, 2025

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ	
Data / Date /Datum:	02.07.2025	
Për / To / Za:	Zyrës së Kryetarit	
Nga / From /Od:	Drejtoria për Administratë	
Lënda / Subject / Tema:	Raport i punës 03 Janar - 30 Qershor / 2025	

RAPORT I PUNËS

Në këtë Drejtori veprojnë 9 Sektorë:

1. Gjendja Civile
2. Qendra për shërbim të qytetarëve
3. Zyra Ligjore
4. Përkthim dhe Lektorim
5. Teknologji Informativë
6. Logjistikë
7. Mjete themelore (pasurisë komunale)
8. Mbrojtjen e fëmijëve dhe ri integrim
9. Arkiva

*Te gjitha lëndët e Drejtorisë për Administratë për periudhën e parashikuar brenda afateve të shqyrtimit janë 0 (zero), të përfunduara me kohë, zgjidhje e tyre në afate rekorde, përgjigje e shpejtë palëve, totali i lëndëve të Komunës janë: **42.563** kurse vetëm nga Drejtoria për Administratë janë: **27.103** apo me përqindje në nivel të përgjithshëm Komunal, vetëm Drejtoria e Administratës ka **63.7 %** të lëndëve.*

NGA DREJTORIA PËR ADMINISTRATË JANË REALIZUAR KËTO PUNË DHE PROJEKTE:

- 1.Drejtoria për Administratë për gjashtë muaj i ka përfunduar 29261 lëndë.
- 2.Ka vendosur rrjetin e kamerave te qytetit në të gjithë territorin e Komunës tonë.
- 3.Ka menaxhuar punën me 30 këshilla lokal.
- 4.Ka përfunduar të gjitha pagesat në kohë.
- 5.Ka fituar projekt nga IOM për përdorim të gjuhëve zyrtare në nivel Republike.
- 6.Ka menaxhuar punën me lëndë në logjistike, furnizime të ndryshme për administratë komunale
- 7.Shenimi i ditëve për fëmijë dhe riaktivizimi i asamblesë komunale për fëmijë.

VENDOSJA E TË DHËNAVE SIPAS RAPORTEVE NGA SEKTORËT:

Bazuar në raportet e dërguara nga Udhëheqësit e sektorëve në Drejtorinë e Administratës, raporti i punës për periudhën 03 Janar – 30 Qershor 2025 është si vijon:

1. SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Ka kryer këto shërbime:

1.Vendime për regjistrim me vonesë ne RTHL	19
2.Vendime për regjistrim me vonesë në RTHV	89
3.Vendime për korrigjime të emrit/mbiemrit	59
4.Vendime për ndërrim të emrit/mbiemrit	53
5.Regjistrime në RTHL-ve	933
6.Regjistrime në RTHV-ve	446
7.Regjistrime në RTHM-ve	394
8.Lëshuar certifikata të lindjes	9824
9.Lëshuar ekstrakte të lindjes	21451
10.Lëshuar certifikata të kurorëzimeve	5176
11.Lëshuar certifikata të vdekjes	3128
12.Lëshuar certifikata të statusit martesor	997
13.Lëshuar certifikata të vendbanimit	2816
14.Lëshuar certifikata të shtetësisë	383
15.Lëshuar deklarata të Bashkësisë Familjare	2793
16.Lëshuar vërtetime nga Arkiva	680
17.Raporte për lindje statistikës DEM-1	933
18.Raporte për vdekje statistikës DEM-2	446
19.Raporte për kurora statistikës DEM-3	394
20.Aplikime për tu liruar nga shtetësia e Kosovës	9
21.Aplikime për ta fituar shtetësinë e Kosovës	90
22.Aplikime për te rikthyer shtetësinë e	81
Gjithsej shërbime të kryera:	51194

Janë realizuar taksa nga zyrtaret dhe e-kiosku: 14.506 Euro.

Gjithsej shërbimet të kryera.....

VËREJTJE :Në shumën e taksës nuk përfshihen pikat 17.18 dhe 19

2. QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

- Qendra për Shërbim me Qytetar gjatë periudhës kohore janar/qershor '2025 ka ndërmarr një seri aktivitete të ndryshme në kuadër të Drejtorisë për Administratë si dhe me Institucionet tjera relevante që ndërlidhen me këtë sektor.
- Qendra për Shërbim me Qytetar gjatë periudhës kohore janar/qershor 2025 ka pranuar kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara dhe të destinuara në Drejtori të ndryshme sipas tabelës së më poshtme:
- Në Qendrën për Shërbim të qytetarëve kanë kaluar lëndë nga te gjitha Drejtoritë, lëndët nga Drejtoria për Administratë janë aprovuar nga zyrtarët e Drejtorisë për Administratë.
- Kjo qendër ka pranuar gjithsej 45.563 kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara dhe të destinuara në drejtori të ndryshme sipas tabelës së më poshtme:

Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

03/01/2025 - 30/06/2025

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DAP	Drejtoria për Administratë	21	55	4,057	37	0	1	0	9	25,081	29,261
DKA	Drejtoria për Arsim	2	119	1,676	3	0	1	0	80	0	1,881
KK	Kuvendi Komunal	0	8	26	0	0	0	0	0	0	34
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	5	417	633	9	0	0	0	1	0	1,065
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	0	167	0	0	0	0	0	0	0	167
DMS	Drejtoria për Mirëqënje Sociale	0	37	2	0	0	4	1	0	0	44
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi	0	367	134	0	0	0	0	0	0	501
DUMM	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	1	217	454	95	2	64	0	1	0	834
KK	Kryetari i Komunës	3	34	955	41	0	191	1	12	0	1,237
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	0	129	37	0	0	0	0	0	0	166
DKGJ	Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi	29	194	7,440	5	0	11	0	108	0	7,787
DPKSHP	Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike	0	142	160	57	0	1	0	0	0	360
DMSH	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	0	40	13	0	0	0	0	0	0	53
DBPH	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi	0	41	386	490	0	1	1	2	0	921
DPI	Drejtoria për Punë Inspektuese	0	224	20	1	1	0	0	0	0	246
DPÇPJ	Drejtoria për çështje Pronësoro-Juridike	2	109	832	1	0	1	0	16	0	961
Prokurimi	Prokurimi	0	45	0	0	0	0	0	0	0	45
		63	2,345	16,825	739	3	275	3	229	25,081	45,563

Qendra për Shërbim të Qytetarëve - ARKIVA

Njësia e Arkivës në periudhën kohore i ka kryer të gjitha detyrat e punës të cilat janë në përgjegjësi dhe fushëveprim i kësaj zyre. Zyra e Arkivit e Komunës së Pejës ka kryer punët duke u përkujdesur në zbatimin e ligjeve të aprovuara dhe harmonizimi i akteve të ndryshme me Ligjin Nr04/L-088 për Arkivat Shtetërore ,Ligjit Nr.04/L- 184 për Administrimin e Punës në Zyre dhe të Rregullores MAP Nr. 01\2015 për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afateve e ruajtjes së tyre. Gjatë këtij viti jemi munduar për ti arritur këto objektiva të cilat edhe i përcakton vendi i punës.

- Janë pranuar dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe jemi kujdesur për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore.
- Sistemimi dhe mirëmbajtja e lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit.
- Mirëmbajtje e arkivit të veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruajtja e paprekshmërisë së informatave.
- Seleksionimi i rregullt i lëndëve arkivore.
- Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit.
- Ndërmarrje e veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës.
- Koordinim i punës me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postës, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;
- Kryerja e çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

3. ZYRA LIGJORE KOMUNALE

Gjatë periudhës gjashtë (6) mujore janar/qershor 2025 konkretisht në sektorin ligjore ka kryer këto aktivitetet të cilat po i paraqesim si në vijim:

- 1.Kryesuse i Komisionit për rekurtim 2-raste.
- 2.Anëtar i Komisionit për rekurtim 3-raste.
- 3.Pjesëmarrja në puntori të ndryshme në 2-raste.
- 4.Rishqyrtimi i akteve të përgjithshme/rregulloreve sipas vrejtëjeve të Ministrisë 1-raste.
- 5.Interpretime ligjor për drejtoritë në 2-raste.

4. PËRKTHIM DHE LEKTORIM

Zyra e përkthimeve ka kryer punën e vet në harmoni me Ligjin për përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë.

Të gjitha dokumentet që kanë ardhur për përkthim në këtë zyrë janë përkthyer, në afat, me kohë dhe pa ndonjë vonesë (dokumente dhe materiale të ndryshme nga të gjitha drejtoritë dhe zyrët, komitetet dhe organet tjera të komunës).

Prej muajt Janar gjerë në Qershor të vitit 2025, janë **përkthyer gjithsejtë 353 faqe material të ndryshëm, si dhe 30 orë si dhe 6 ore e 10 minunta** përkthime të drejtpërdrejta në takime të ndryshme në objektet e Komunës dhe në terren. Më poshtë po japim një pasqyrë të dokumenteve kryesore dhe të vazhdueshme që janë përkthyer:

1. Procesverbalet e Kuvendit të Komunës;
2. Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Procesverbalet e Komitetit për komunitete;
4. Procesverbalet e KKS-së;
5. Procesverbalet e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara,
6. Procesverbalet e Komitetit konsultativ për zhvillim ekonomik,
7. Procesverbalet e Komitetit konsultativ për mbrojtje të mjedisit,
8. Vërtetime të ndryshme;
9. Vendime dhe Aktvendime të ndryshme;
10. Konkurse të ndryshme, konkluzione, njoftime, ftesa;
11. Njoftime të ndryshme, Plane dhe strategji;
12. Projektet të ndryshme.

5. TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Janë kryer punë të përditshme, dhe është raportuar çdo ditë pune, numri i kërkesave të realizuara është:
764 Kërkesa.

Bazuar në kërkesat tjera për menaxhim dhe implementim, me poshtë gjeni të dhënat:

- Planifikim për riparimin e rrjetit, kërkesë drejtuar drejtorisë për vendosje në planin e prokurimit
- Kontribut i dhënë nga sektori për Teknologji Informative rreth përgatitjes për shërbimet e E-Kosova, në pjesën ku përfshihen të dhënat e kërkuara nga Komuna Pejë
- Laura menaxhimi i bazës së të dhënave nga Sektori për TI-ve.
- Zyrtarët nga sektori i TI-ve, Pjesëmarrje në shumë Komisione, takime të ndryshme, punëtori dhe konsulta.
- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e Sektorit
- Përgatitje e paramasave për punë të ndryshme nga Sektori për Teknologji Informative
- Menaxhimi i bazave të të dhënave lokale të krijuara me zero kosto.
- Menaxhimi i bazave të të dhënave nga ASHI.
- Menaxhimi i e-kioskut
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për Teknologji Informative – Kompjuterëve
- Mirëmbajtja dhe intervenimet për kamerat e qytetit dhe objekteve
-

Për raport me të detajuar dorëzohet aneksi i veçantë të Drejtoresha e Drejtorisë

6. LOGJISTIKA

Udhëheqësit e Sektorëve së logjistikës është si vijon:

- 1.Mirëmbajtja e objekteve komunale
- 2.Mbikqyrja e pastrimit të objekteve dhe furnizimi me material të pastrimit
- 3.Kontrollimi dhe mirëmbajtja e nxehmjes qendrore si dhe furnizimi me lëndë djegëse
- 4.Mirëmbajtja e veturave si dhe servisimi i tyre
- 5.Lyerja dhe rregullimi i 6-shtë zyreve në ndërtesën kryesore
- 6.Mirëmbajtja e ndriqimit publik
- 7.Rregullimin dhe servisimin e gjeneratorit në ndërtesën kryesore pas djegies së instalimit dhe aparaturave elektronike
- 8.Rregullimi i nxehmjes qëndrore në ndërtesën e arsimit
- 9.Rregullimi i nyjeve sanitare në ndërtesën e Administrates
- 10.Regjistrimin e automjeteve të reja (15 veturave)
11. Furnizimi me material hargjues për të gjitha drejtoritë
12. Pranimin e mallit si zyrtarë alternativ për pagesa për të gjitha drejtoritë.
13. . Furnizimi me material shpenzues për nevojat e të gjitha drejtoritëve.
- 14.Pregaditja e lendeve per pages nga Drejtoria e Administrates.
- 15.Bartja e arkives te Urbanizmit ne arkiven e re te Administrates.
- 16.Punet e kryera ne uren te sharra,bartja dhe pastrami i mbeturinave.

7. ZYRA E MJETEVE THEMELORE (PASURISË KOMUNALE DHE E-PASURIA)

- Pagat e punëtorëve për mirëmbajtje dhe sigurim,NPL EKO SIG
 - Bartja e obligimeve te mbetura nga viti paraprak, si dhe kryerja e të gjitha obligimeve te shpenzimeve komunale pas alokimit te buxhetit.
 - Kryerja e pagave për “Eko- Sig”,për Shërbimet Teknike dhe Mirëmbajtja si dhe Sigurimi Fizik.
 - Shpenzimet e rrymës për periudhën dhjetor’24- maj’25
 - Shpenzimet e ujit për periudhën dhjetor’24- maj’25
 - Shpenzimet e telefonisë fikse për periudhën dhjetor’24- maj’24
 - Shpenzimet e mbeturinave për periudhën dhjetor’24- maj’25
- Shpenzimet e rrymës me vendim te Kryetarit për:
- Pompat e ujit Vranoc, për periudhën dhjetor’24- maj’24
 - Radio Peja për periudhën dhjetor’24- maj’24
 - Gorazhdeci, për periudhën dhjetor’24- maj’24
 - KK-Access Action Program (zyra e turizmit afër patrikanës) te gjitha shpenzimet komunale (Rryma, uji dhe mbeturinat),
 - Telefonja.Mobile -Vala, për periudhën dhjetor’24- maj’25
 - Shpenzimet postare për periudhën dhjetor’24- maj’25
 - Pagesat për kycje te rrymës për Shtëpinë e Fshatit-Dubovë dhe vazhdimi i pagesave të rrymës
 - Regjistrimi i lendeve në sistem e-Pasuria,(regjistrimi i materialit shpenzues), si dhe realizimi i kërkesave të zyrtareve për furnizim me material shpenzues për të gjitha drejtorit.
 - Regjistrimi i aseteve ne sistemin e-Pasuria (nxjerrja e barkodeve) ngarkimi dhe transferet sipas kërkesave.
 - Evidentimi i shpenzimeve komunale ne databazen e shpenzimeve,
 - Barazimi i pagesave me kompanitë:”KESCO”,”AMBIENTI” si dhe “HIDRODRINI”
 - nxjerrja e barkodeve për drejtorin e Shëndetësisë, dhe Arsimit.

Punë tjera sipas kërkesave

8. MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE RIINTEGRIM

- Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim ka vijuar të zbatojë me përkushtim mandatin e saj ligjor dhe funksional, në përputhje me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve dhe riintegrim. Kemi udhëhequr, monitoruar dhe krijuar mekanizma dhe programet komunale që kanë për qëllim mbrojtjen e fëmijëve në avancimin e mirëqenies dhe përfshirjes së fëmijëve në jetën shoqërore, edukative dhe institucionale.
- Veprimtaria është zhvilluar përmes:
- **Zbatimit të politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve** në bashkëpunim të ngushtë me Kryetarin të Komunes ,drejtorët e drejtorateve të Komunës së Pejës, , institucionet lokale dhe OJQ-të relevante;
- **Organizimit dhe pjesëmarrjes në trajnime, takime informuese dhe konferenca** që synojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe fuqizimin e mekanizmave lokalë Ekipi për Mbrojtjen e fëmijëve dhe Asambleja Komunale e fëmijëve;
- **Hartimit të planeve të veprimit dhe përpilimit të raporteve zyrtare**, duke mbledhur të dhëna statistikore dhe informacione relevante për të drejtat e fëmijëve në Komunën e Pejës;
- **Këshillimit të organeve komunale** në lidhje me hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e të drejtave të fëmijëve;
- **Iniciimit të projekteve të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërsektorial**, në mënyrë që të krijohen kushte sa më të favorshme për jetën, sigurinë dhe përfaqësimin e fëmijëve në vendimmarrje.
- Përfaqësim në menyre dinjetoze të Komunës së Pejës në nivel qendror nëpërmjet koordinimit me Zyren për Qeverisje të Mire në kuadër të KM dhe Divizionin për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e APL;

Takime Informuese në SHFMU

Takimet informuese me shkollat – Shkurt & Mars 2025

Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim, në kuadër të angazhimeve për funksionalizimin dhe përfaqësimin e fëmijëve në strukturat vendimmarrëse, ka organizuar një seri takimesh informuese me Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta në Komunën e Pejës.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte:

- Prezantimi i punës së Zyrës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim;
- Informimi mbi Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe angazhimet institucionale për zbatimin e tij;
- Shpalosja e rregullores për themelimin dhe funksionimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF) dhe roli i saj në përfshirjen e fëmijëve në proceset vendimmarrëse.

Të gjitha takimet janë zhvilluar në bashkëpunim dhe me përkrahje të zyrtares së DKA-së, Përfaqësuesve të OJQ “Syri i Vizionit” – Pejë dhe OJQ “Save the Children” – Kosova.

Periudha dhe shkollat e përfshira:

18 – 21 Shkurt 2025;

- SHFMU “Vaso Pashë Shkodrani”
- SHFMU “Asdreni”
- SHFMU “8 Marsi”
- SHFMU “Ramiz Sadiku”
- SHFMU “Dardania”
- SHFMU “Smail Hajdari”
- SHFMU “Xhemal Kada”

27 Shkurt – 05 Mars 2025;

- SHFMU “Skënderbeu” – Tërboviq
- SHFMU “Ali Kelmendi” – Nabërgjan
- SHFMU “Rilindja” – Trestenik & Lutogllavë
- SHFMU “Skënder Çeku” – Qyshk
- SHFMU “Haxhi Zeka” – Zahaq
- SHFMU “Zef Serembe” – Gllaviçicë
- SHFMU “Naum Veqilharxhi” – Kliqinë
- SHFMU “2 Korriku” – Logjë
- SHFMU “Mehmet Shoshi” – Llozhë
- SHFMU “Pjetër Budi” – Poçest
- SHFMU “28 Nëntori” – Raushiq
- SHFMU “Fan Noli” – Kryshec
- SHFMU “Dëshmorët e Kombit” – Baran
- SHFMU “Migjeni” – Glllogjan

Seancat të rregullta dhe aktivitete në shenimin e ditëve të rendesishme vendore dhe nerkombetare me Asamblenë Komunale të Fëmijëve (AKF)

- 26.02.2025 – Seancë e pare e rregullt e Asambles KOMunale të Fëmijëve;
- 07.03.2025 – Hartimi i planit të punës të AKF-së për vitin 2025;
- 21.03.2025 – Shënimi i Ditës Ndërkombëtare Sindromës Down;
- 02.04.2025 – Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Autizmit;
- 22.04.2025 – Seanca e dytë e AKF-së dhe Shënimi i Ditës së Tokës;
- 20.05.2025 – Vizitë njetitore ne Tiranë te AKF-së;
- 30.05.2025 – Seanca solemne për 1 Qershorin dhe 20-vjetorin e AKF-së;
- 09.06.2025 – Seanca e katërt e AKF-së dhe zgjedhja e komisioneve;
- 11.06.2025 – Pjesëmarrje e AKF-së në dëgjime buxhetore;
- 16.06.2025 – Manifestim për ditën e Çlirimit të Pejës.

Trajnime

- 24–26.02.2025 – Trajnim nga OSBE.
- 21.03.2025 – Trajnim nga "Advancing Together"
- 7 - 8 .04. 2025 Trajnim nga DEMOS.
- 12–14.05.2025 – Punëtori II nga OSBE

Pjesmarrja në konferenca, panair dhe publikime

- 10.03.2025 – Panairi për 8 Marsin nga IOM, ZBGJ dhe DKRS.
- 07.05.2025 – Konferencë nga MAPL, ZKM, Syri i Vizionit dhe Save the Children për Udhëzimin Administrativ për të Drejtat e Fëmijëve.
- 03.04.2025 – Lansimi i Manualit për AKF-të nga Save the Children në Prishtinë.
- 23.05.2025 – Prezentim i projektit për gjuhët zyrtare dhe intervistë me Save the Children për mekanizmat e raportimit në shkolla.

Bashkëpunime me OJQ-t“Syri i Vizionit” - Pejë, “Save the Children”- Kosova,“Qendra për Jetë të Pavarur”, Hendikos, Duart Plotë Mëshirë, ”Pema”,“Medica Kosova”, “Advancing Together, IOM et.

Të gjitha aktivitetet janë realizuar në përputhje me planin e punës të propozuar dhe të aprovuar, me synim zbatimin e plotë të përgjegjësiwe institucionale dhe ligjore për mbrojtjen dhe përfshirjen e fëmijëve.

Njësia e Arkivës në periudhën kohore i ka kryer të gjitha detyrat e punës të cilat janë në përgjegjësi dhe fushëveprim i kësaj zyre. Zyra e Arkivit e Komunes së Pejës ka kryer punët duke u përkujdesur në zbatimin e ligjeve të aprovuara dhe harmonizimi i akteve të ndryshme me Ligjin Nr04/L-088 për Arkivat Shtetërore, Ligjit Nr.04/L- 184 për Administrimin e Punës në Zyre dhe të Rregullores MAP Nr. 01\2015 për shenjat unike të klasifikimit të dokumentave dhe afateve e ruajtjes së tyre. Gjatë këtij viti jemi munduar për të arritur këto objektiva të cilat edhe i përcakton vendi i punës,

Kemi pranuar dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe jemi kujdesur për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;

Dhe jemi kujdesur për sistemimin dhe mirëmbajtjen e lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;

Kemi mirëmbajtur arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;

Dhe jemi përkujdesur për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;

Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me Arkiven ndërkomunale, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;

Dhe kemi ndërmarr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;

Dhe kemi koordinua punën me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postës, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;

Dhe kemi kryer çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Pejë, 02.07.2025

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë:

Nita Panduri-Mullarama

Drejtoria Komunale e Arsimit- Nr.prot. 568/29 17.07.2025	 KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEÇ MUNICIPALITY OF PEJA	PERIUD HA RAPORT UESE
Naser gega Naser gega@rks-gov.net		JANAR Qershor
044-221-164		DATA: 17.07.2025

Nr. Ref .	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës duhet të behën sipas planit të prokurimit, bazuar ne buxhetin e parapare për investime kapitale për vitin 2025	Muaji i realizimit përfshirë edhe procedurën e prokurimit	Çmimi i planifikuar në Euro
1.	Furnizim me materiale te textilit (Çarshafa , jorgana , jasteka,dyshek) për nevojat e qerdheve dhe shkollave	Shkurt 2025	15.000,00
2.	Blerja e shtretereve dhe ormanave per cerdhet e K. Pejes	Shkurt 2025	25.000,00
3.	Blerja e kompjutereve dhe paisjeve percjellese për shkolla	Shkurt 2025	20.000,00
4	Renovimi i Sallës së sportit në Shfmu”Lidhja e Prizrenit”	Mars 2025	39,043.32
5	Punimi I murrit në objektin shkollor-Qerdhe	Mars 2025	21,632.95
6.	Blerja e 3 makinave për kositje të barit në shkollat : Shfmu”Zef Serembe” ,”Naum Veqilharxhi “ dhe ” Mehmet Shoshi”	Prill 2025	900.00
7.	Plani rregullues i hapsirave të jashtme të shkollës”Pjeter Budi” Poçestë	Mah 2025	29,581.06

Raport pune : Janar –Qershor 2025

- Mbledhje me drejtorët e shkollave –përgaditjet për fillimin e gjysëmvjetorit të dytë - 30 janar 2024
- Në muajin janar janë bër 4 vlerësime të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore nga Ekipi Komunal i vlerësimit të fëmijëve me NEV arsimore-janar 2025
- Pëzgjedhja nga DKA e dy shkollave: **Shfmu”Lidhja e Prizrenit** dhe **Shfmu”Dardania”** për realizimin e Projektit të**“Fondacion Utalaya”,për vitin 2025”-janar - shkurt 2025**

• Shpallja e konkursit për plotësimin e vendeve të punës :vende të lira nga të pensionuarit dhe zëvendësime(pushime të lindjes ,pushime mjekësore, me 21.01.2025

- Organizimi dhe përzgjedhja e dy shkollave :**Shfmu”Tetë Marsi “** dhe **Shfmu”28 Nëntori”** me nxënës të klasave të VII-ta, në realizimin e projektit „Shkolla Dimrore e Skijimit’ -27 shkurt - 5mars 2025
- Përzgjedhja nga komisioni në DKA,mësimdhënësin më të dalluar nga shkollat e Komunës së Pejës- mësimdhënësi i lëndës së matematikës në Gjimnazin “Bedri Pejani” z.**ADEM TOLAJ** i cili do e përfaqësoj komunën e Pejës në përzgjedhjen e mësimdhënësi të dalluar për **çmimin “Shaban Jashari”** me datë 7 mars 2025 në ambijentin e Biblotekës Kombtare të Kosovës
- Organizimi nga DKA i drekës solemne dhe shpërndarjes së mirënjohjeve për 40 mësimdhënësit e pensionuar (nga data 7mars 2024 -7 mars 2025) dhe 11 mirënjohje postmortum, për nderë të 7 Marsit –ditës së Mësuesit.

• Zhvillimi i proceduraeve të rekrutimit të puntorëve të rinjë(testet me shkrim,intervista ,vendimet per pranim)etj-shkurt-mars 2025

• Organizimi i Ligjeratave nga Policia Rajonale, në dhjetë shkolla të komunës së Pejës, **TEMA:”Pasojat e përdorimit të Narkotikëve”, për Klasat e VII-IX" - dt. 24-28 shkurt 2025**

• Takimi informues në MASHTI me drejtorin e DKA-së,Koordinatorin komunal per PISA dhe drejtorët e shkollave të mesme të Larta -pregaditjet për organizimin e testit PISA 2025 - dt . 19 mars 2025

- Implementimi i projektit” **Shëndeti dhe Mirëqenia e nxënësve** “në 16 shkolla të Komunës së Pejës me nxënës të klasave II-të, V-të dhe e IX-të,me bashkëpunim me Drejtorin e Shëndetësisë - Mars-Qershor 2025
- Organizimi nga DKA i **Olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe ,për klasën e 9-të, për vitin shkollor 2024-2025 (Kosovë – Shqipëri),në nivel shkolle me 200 nxënës ,** Faza I-rë, 11 mars 2025, ora 9.00-11.00.
- Organizimi i Olimpiadës së përbashkët të gjuhës shqipe për klasën e 9-të, për vitin shkollor 2024-2025 (Kosovë – Shqipëri), Faza II-të, 20 mars 2025, ora 10.00-12.00. cili u realizua në nivel Komune , në ambientin e Shfmu’Tetë Marsi”
- Mbledhja e shënimeve dhe konfirmimi i **numrave të nxënësve rezident** ,bazuar në kërkesën e e Zyrës kombëtare të Auditimit dt 10.03.2025
- Vlerësimi i performances të katër drejtorave të shkollave të cilëve do t’ju skadoj kontrata në vitin 2025 ,nga Udhëheqësja e sektorit të Arsimit në DKA; Drejtores të shkollës së Muzikës,drejtores së IP”Pëllumbt e Paqës”,drejtorëve të Shfmu:”Ali Kelmendi” dhe Hil Mosi” prej 10- 21 mars 2025
- Organizimi i Ligjeratave nga Policia rajonale, në dhjetë shkolla të komunës së Pejës, **TEMA: Bullizmi dhe masat parandaluese Klasat e VI-IX - dt. 24-28 mars 2025**
- Organizimi i Olimpiadës së KIMISË, në DKA-Pejë , me datë 27.03.2025 pjesëmarrës ishin 19 nxënës nga Gjimnazi “Bedri Pejani” dhe Gjimnazi”Cambridge school” .
- DKA dhe zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim kanë organizuar aktiviteteteve me psikologët e shkollave fillore të mesme të ulta për të shënuar 2 Prilli - Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizëm dt: 2 Prill 2025

- Organizimi i takimit informativ në DKA për testin PISA 2025, me Koordinator të shkollave të komunës së Pejës , komunës së Deçanit dhe DVS MASHTI-n dt.4.04.2025
- Organizimi i vizitës 5 ditore në qytetin Bursa të shtetit të Turqisë nga ana e ekipit të përbërë nga zyrtar komunal ,drejtor shkollave të binjakëzuara me shkollat e qytetit të BURSA .Shkollat e binjakëzuara me shkollat e Burses janë : Shfmu; Asdreni, Xhemajl Kada, Hil Mosi, V.P. Shkodrani, , IAAP”Rifat Gjota” ,IP”Pëllumbat e Paqës” si dhe shkollat të cilat për here të parë u binjakëzuan :Shfmu”7 Shtatori “ dhe Shfmu”, 28 Nëntori “ -dt .08.04.2025
- Organizimi i Olimpiadës së Kimisë në nivel Regjional ku nga komuna e Pejës garuan 11 nxënës të klasave të X-ta,XI-ta dhe XII-ta.Testi u realizua në objektin e gjimnazit “Bedri Pejani” dt. 19.04.2025
- Përzgjedhja e dy shkollave fillore të mesme të ulta të komunës së Pejës ,Shfmu”Asdreni “ dhe Shfmu “Tetë Marsi”për realizimin e aktiviteteve me nxënës, për shënimin e javës “rritja e vetëdijes dhe përgatitjes për menaxhimin e situatave emergjente”, projekt I Agjencisë për Menaxhim Emergjent - dt 22.04.2025
- Caktimi i datave dhe qendrës për mbajtjen e testit PISA 2025, me 424 nxënës të përzgjedhur nga MASHTI në 11 shkolla të Komunës së Pejës poashtu të caktuara nga MASHTI ,të moshës 15 vjeç
- Takim informues në DKA, me psikolog dhe pedagog të shkollave të komunës së Pejës së bashku me komisionin e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor nga Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Pejë- dt.23.04.2025
- Pritja e delegacionit nga qyteti Bursa të Turqisë ,vizitë shkollave të binjakëzuara - dt:28.04.2025
- Implementimi i projektit “Java e dyerve të Hapura “ ,në bashkëpunim me Qendrat e karrierës të dy shkollave profesionale :IAAP “Rifat Gjota” dhe SHMLE “Ali Hadri”-Organizimi i transportit të nxënësve të klasave të nënta nga shkollat e fshatit në sheshin e qytetit ku bëhet promovimi i profileve dhe drejtimeve të shkollave profesionale- 6 maj 2025
- Përzgjedhja e mësimeve të cilat shprehin gadishmëri për trajnimet të organizuara nga QBMK”Xheladin Deda”me dy module, trajnimi katër ditorë nga 4 orë:
-Gjithëpërfshirja në sistemin arsimor në Kosovë,integrimi i fëmijëve të verbër dhe
- Plani individual i Arsimit –PIA me dt.6,7,13,14,,20,21,27 dhe 28 maj 2025
- Organizimi i Testit PISA 2025 me gjithsej 424 nxënës të moshës 15 vjeç nga 11 shkolla të përzgjedhura,të komunës së Pejës (6 SHML dhe 5 SHFMU) në qendren IAAP”Rifat Gjota” si dhe furnizimi nga ana e DKA-së me nga një shujtë(ujë dhe nga një popkek për secilin nxënës. me dt. 13,14,15,16,19,20 dhe 21 maj 2025
- Pregaditjet për pjesëmarrjen e nxënësve të klasës së parë me mësuesen Arta Buquku të SHFMU”Dardania”- që do ta përfaqësoj Komunën e Pejës në manifestimin “Festa e Abetarës”-Prizreni 2025 në nivel vendi, me dt:16.05.2025
- Planifikimi i Regjistrimit të nxënësve në klasën e I-rë në shkollat e komunës së Pejës, fillimi i regjistrimit 16.05.2025
- Shpallja e konkursit për drejtor të katër SHFMU dhe dy zëvendës drejtor të SHFMU - 16.05.2025
- Vlerësimi i tetë nxënësve me NEV arsimore nga Ekipi Komunal për Vlerësim të Fëmijëve me NEV, gjatë muajit maj 2025
- Takim në DKA me drejtor të shkollave për temat:suksesin e nxënësve në përfundim të vitit shkollor 2024/25 ,nevojat e shkollave me kuadër arsimor , furnizimi i shkollave me nga një kompjuter nga DKA,nevojat e shkollave për gëlqerosje dhe riparime.....me dt 27.05.2025
- Shqyrtimi i kërkesave të drejtorve të shkollave për gëlqerosjen e objekteve shkollore si dhe furnizimi me material të nevojshëm 27.05.025
- Njoftimi i maturantëve për fillimin e aplikimit për test të Maturës 2025 në platformen E-Kosova nga data 27.05.2025

- Caktimi i qendrave të testimit dhe administruesve për test të arritshmërisë 2025- maj 2025
- Shpërndarja e kompjuterëve për secilin drejtor shkolle
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me Federatën e Sportit në Shkollë dhe fëmijët e moshës 0-5 vjeç të çerdhës “Pëllumbat e Paqës” në kuadër të projektit “Sporti në Çerdhe “për nder të “1 Qershori-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve”
- Përgaditjet për shënimin solemn të ditës së Çlirimit të Pejës - 16 Qershori si dhe përzgjedhja e nxënësve në aktivitete ,për nder të kësaj dite. me 28.05.2025
-Aktivitete të realizuara:
Ekspozita në Korzo e realizuar nga nxënësit e Shfmu”Tetë Marsi”
Marshi i nxënësve të klasës së V-të të shkollave fillore
Homazh i nxënësve të Memoriali i fëmijëve “Te Lapsat”
Vizitë në Galeria e Arteve” Ekspozitë me Kampionët Olimpik”
- Raportimi në MAPL nga fusha e arsimit për Përformanc të Komunës 2024- dt.12 qershor 2025
- Zhvillimi i procedurave të konkursit për drejtor të shkollave –qershor 2025
- Shqyrtimi i ankesave të nxënësve dhe mësimitdhënësve ,nga shkollat
- Lëshimi i vërtetimeve për vitet 1990/99
- Vlerësimet e fëmijëve me NEV nga Ekipi komunal i Vlerësimit -prill-qershor
- Përzgjedhja e Objektivit të ri të IP “Pëllumbat e Paqës” në Vitomiricë – 10 qershor
- Vizita të rregullta në shkollë
- Përgaditjet për mbajtjen e testit të Maturës 2025-(21.06.2025)
- Përgaditjet për mbajtjen e testit të Arritshmërisë 2025 (27.06.2025)
- Shpërndarja e rezultatit të testit të Maturës 2025 në shkollë të mesme të larta ,shqyrtimi i ankesave.
- Kalueshmëria në nivel Komune (75.34 %)

Raport i realizimit të i aktiviteteve nga Zyrtari për Teknologji Informativ Janar –qershor 2025

-Përditësimi i softuerëve dhe sistemit operativ për pajisjet ekzistuese.

-Mbështetje teknike për mësuesit për përdorimin e aplikacioneve mësimore dhe zgjidhjen e problemeve të lidhjes së pajisjeve.

Administrata

-Përgjigje në kërkesa dhe ankesa të palëve , bazuar në ligj dhe vendosja në programin INTRANET

-Shpallja e konkurseve për mësimitdhënës,plotësimi i vendeve të liruara (pushimet e lindjes)

-Pranimi i Aplikacioneve në konkurset e shpallura

-Zbatimi i detyrave administrative si : vendimet e ndryshme ligjore për mësimitdhënës dhe palë të tjera,kontratat e punës, vendimet për nderprerje të marrdhënies së punës, pushimet pa pagesë ,pushimet e lehonise etj

-Pelqime ,Rekomandime ,njotime për shkollë

-Pjesëmarrja në vendime të komisioneve disiplinore,te ankesave etj.

Sektori I Financave

- PËRCJELLJA E NDRYSHIMEVE NË LISTËN E PAGAVE Janar-qershor 2025

-Zotimi i mjeteve dhe regjistrimi ne formë kompjuterike

-Percjellja e mjeteve te alokuara dhe mjeteve te shpenzuara

-Analiza e buxhetit rreth raportit planifik-shpenzim per periudhe janar – qershor 2025

- Futja e te dhënave per komunalitet ne databazen e instaluar nga zyra e IT-se se Komunes.



**RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËVE
TË KRYERA DHE AKTIVITETEVE
NGA DREJTORIA PËR BUJQËSI,
PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI**

QERSHOR, 2025

Përmbajtja:

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

1.1.Tabela e kërkesave të ndara sipas numrit dhe statusit

1.2.Tabela e kërkesave sipas kategorive

1.2.1. Inksasimet e të hyrave nga vendimet për ndërrim të destinacionit të tokës

1.3.Rritja në përqindje e kërkesave të parashtruara në DBPH për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025

1.4.Kërkesat e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe vërshimet

2.SUBVENCIONET NGA DREJTORIA PËR BUJQËSI

2.1 Përkrahja e fermerëve më mekanizëm bujqësor

3.AKTIVITET E DREJTORISË PËR BUJQËSI

4.1 Monitorimi i Vendgjuetive

4.2 Takim me fermerë për mbështetjen e politikave mbështetëse për fermerë

4.3 Vazhdimi i implementimit të bashkëpunimit me Organizatën “Islamic Relief Kosova”

4.4 Promovimi i projektit “Trajtimi i qenëve dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”.

4.5 Inspektimi i punëve tek kanalet e ujitjes sipas kontratave të nënshkruara

4.6 Konsultimi Publik për Draft Rregulloren për Taksa dhe Tarifa Komunale

4.7 Përmbyllja e projektit “Furnizim me serra dhe mekanizëm bujqësor”, bashkëpunim me IRK

4.8 Takim me gratë bletare organizuar nga EcoKosWomen (EKW)

4.9 Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me KRU “Drini i Bardhë”

5.INVESTIMET KAPITALE

5.1 Planifikimi i inv.kapitale (kanaleve të ujitjes) për vitin 2025-2026

6.SUBVENCIONET E MBPZHR

6.1 Afati i aplikimit për TM2 i vitit 2024

6.2 Afati i aplikimit në Programin e Pagesave Direkte për sipërfaqet e mbjellura me kultura bujqësore të përcaktuara në PPD 2025

HYRJE

Puna (veprimtaria) gjashtë mujore (6M) në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi përfshinë koordinimin e zhvillimeve në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë. Kemi punuar në përmirësimin e rendimentit (produktivitetit) në kulturat kyçe, rritjen e përdorimit të teknologjisë moderne në bujqësi si dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore (kanale, penda).

Gjatë këtij gjashtëmujori kemi implementuar projekte inovative, si trajnime për fermerët dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme.

Për sfidat e hasura, kemi zhvilluar strategji për të adresuar çështje (problematika) të ndryshme në të mirë të fermerëve në territorin e Komunës së Pejës.

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

Gjatë gjashtëmujorit të parë (I-rë) kemi pranuar gjithsej **735** kërkesa. Këto kërkesa janë të llojeve dhe natyrave të ndryshme. Shqyrtimi i tyre është bërë nga zyrtarët e DBPH-së dhe janë përfunduar mbrenda afateve të caktuara kohore, me përjashtim të një numri kërkesash të cilat janë ende në shqyrtim për shkak se priten përgjigje nga Ministria e Bujqësisë si dhe Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve.

1.1 Në tabelën e posht-shënuar janë të paraqitura kërkesat e ndara sipas llojit, numrit dhe statusit:

	Të pranuar	Në proces	Të miratuara	Të refuzuara	Hedhur poshtë	Të pezulluara	Të anuluar
	735	35	551	149	0	0	0

1.2 Kërkesat sipas kategorive:

Kërkesa për marrje me qira të tokës komunale	Kërkesa për të ndërrim destinacionit të tokës	Kërkesa për vërtetim që është i regjistruar si fermer/për aplikim vizë	Kërkesa për dëme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore	Kërkesa për aplikim mekanizëm bujqësor	Kërkesa natyrave ndryshme
1	9	0	8	657	60

- **1.2.1 Kërkesa për marrje me qira të tokës bujqësore komunale:** një aplikues si person fizik. Aplikues si person juridik nuk kemi pasur.
 – Kjo kërkesë do miratohet në ditët në vazhdim pasiqë deri më tani nuk e kemi pasur si taksë në Rregulloren Komunale për Taksa dhe Tarifa.
 Kjo taksë është vendosur në Rregulloren Nr. 02-2025 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale dhe konfirmimin e ligjshmërisë, të seancës së rregulltë të dt. 29.05.2025.
- **1.2.2 Ndërrimi i destinacionit të tokës:** 1 aplikues si person juridik dhe 8 aplikues si persona fizik.
Totali i të hyrave – 32,856.75 €

Numër i konsiderueshëm i kërkesave në sistem kanë qenë edhe aplikuesit të cilët kanë aplikuar në Thirrjet Publike të shpallura nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Janë punuar shkresa të ndryshme për Ministrinë e Bujqësisë, rekomandime për Zyrën e Kryetarit dhe Zyrën e Prokurimit, Vendime, Procesverbale të vlerësimit të dëmeve etj.

1.4 Në Komisionin Komunal për Vlerësimin e Dëmeve janë pranuar dhe janë në shqyrtim pesë (5) kërkesa të dëmeve të shkaktuara nga fatkqesitë e ndryshme natyrore si dhe dëme të shkaktuara në sektorin e blegtorisë nga sëmundje të ndryshme.

2. SUBVENCIONET E D.B.P.H

2.1 Në bazë të planifikimit buxhetor dhe planit të prokurimit, Drejtoria për Bujqësi më dt. 04.02.2025 ka shpallur Thirrje Publike për aplikim në projektin **“Përkrahja e fermerëve/bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor”**, më vlerë totale **166,950.00 Euro**, projekt ky ku komuna ka participuar me 70% kurse fermerët 30 % të vlerës së përgjithshme financiare.

Për këtë projekt kanë aplikuar **657 fermerë**, ku **172** prej tyre, nga komisioni vlerësues, janë përzgjedhur përfitues.

Mekanizmat e shpërndarë janë:

1. Freza 1.8m (60 copë)
2. Freza 2.0m (20 copë)
3. Spërkatëse 400 L (25 copë)
4. Mikser për përgaditjen e ushqimit të kafshëve (5 copë)
5. Mbjellëse e grurit 16 rendëshe (10 copë)
6. Rotokosa 135 (10 copë)
7. Rotokosa 165 me kardan (10 copë)
8. Mbjellëse dy rendore e patates (4 copë)
9. Mbjellëse 5 rendëshe e qepujkave (4 copë)
10. Nxjerrëse e patates/qepës një rendore (4 copë)
11. Grabuja me traka me kardan (20 copë).

2.2 Gjatë muajit qershor pritët, që për fermerë nga lista e pritjes (nga aplikacionet e mbetura), të shpallet edhe grupi i dytë i përfituesve në projektin **“Përkrahja e fermerëve/bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor”**, më vlerë totale **80,100.00 Euro** , ku do përkrahen gjithsej 77 fermerë.

Edhe në pjesën të dytë të projektit në fjalë, gadishmëria për participim, do të jetë: 70% Komuna e Pejës dhe 30% fermeri përfitues.

Do të shpërndahen këto paisje:

- **Freza 1.8 (30 copë)**
- **Freza 2.0 (15 copë)**
- **Spërkatëse (8 copë)**
- **Rotokosa 135 (12 copë)**
- **Rotokosa 165 me kardan (12 copë).**

3.INVESTIMET KAPITALE

5.1. Sipas planifikimit buxhetor dhe planit të Prokurimit janë kontraktuar gjithsej pesë (5) **LOTE** për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatrat e Komunës së Pejës, bazuar në kërkesat e fermerëve si dhe kryetarëve të Bashkësive Lokale.

Kanalet e planifikuara, janë në këto fshatra: Vragoc, Pavlan, Qyshk, Gllaviqicë, Ramun, Trestenik, Nabërgjan, Loxhë, Çallapek, Baran, Raushiq, Dobërdol, Kosuriq, Broliq, Graboc, Llabjan, Ruhot, Nakëll, Ozdrim, Dubovë, Leshan, Kliqinë si dhe në fshatrat e Podgurit.

Sipas raporteve të mbikëqyrësve të kontratave për kanale dhe pagesave të realizuara nga DBPH më poshtë gjeni tabelarin e punëve të kryera:

5.2 NË TABELËN MË POSHTË JANË TË PARAQITURA PROJEKTET E KONTRAKTUARA TË INVESTIMEVE KAPITALE 2024-2026:

Nr.	Projekti	Shuma e kontratës	Të paguara	Përfunduar/ Në proces	Pagesat në % të punëve të realizuara
1.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Baran i Ulët, Baran i Epërm, Çallapek, Kosuriq, Penda e Vranocit dhe Broliq, LOT 1	198,979.50	73,480.84	Në proces	36.92%
2.	Ndërtimi i kanaleve në fshatrat: Loxhë, Vragoc, Dobërdol dhe Graboc, LOT 2	131,225.50	38,137.00	Në proces	29.06%
3.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Pavlan, Gllaviqicë, Ramun, Leshan dhe Kliqinë, LOT 3	128,994.50	41,000.00	Në proces	32.78%
4.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Trestenik, Nabërgjan, Llabjan, Dardania III, Ruhot dhe Nakëll, LOT 4	188,264.00	172,868.25	Në proces	91.82%
5.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Ozdrim, Dubovë, fshatrat e Podgurit dhe ndërtimi i mureve të Pendës së Vranocit, LOT 5	164,444.44	72,960.00	Ne proces	44.36%

5.3 Për gjashtëmujorin e parë (I-rë) të vitit 2025, pagesat e kryera nga investimet kapitale dhe subvencione në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, janë:

Investime kapitale – **233,602.75** Euro (Të planifikuara **550,000.00** €) – Realizimi **42.47** % i buxhetit.

Subvencione – **154,966.96** Euro (Të planifikuara **270,000.00** €)- Realizimi **57.40** % i buxhetit.

4. AKTIVITET E D.B.P.H-së

4.1 Monitorim i vazhdueshëm i Vendgjutive. Shoqata e Gjuetarëve “Rreqebulli” në periudhën dimërore ka ndihmuar kafshët e egra malore duke u përkujdesur për ushqyeshmërinë e tyre.

4.2 Më dt.14 janar 2025, Komuna e Pejës përmes Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, ka mbajtur takim me fermerë për të diskutuar nga afër nevojat dhe kërkesat e tyre, në mënyrë që DBPH t'i hartojë politikat e mbështetjes së fermerëve, investime këto të cilat ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjes së prodhimeve bujqësore.

4.3 Gjatë muajit shkurt 2025, ka vazhduar implementimi i projektit “Përkrahja e fermerëve në ngritjen e serrave” (vazhdimi i montimit të serrave të fermerëve përfitues), sipas marrëveshjes në mes të Komunës së Pejës dhe IRK – Zyra në Kosovë.

4.4 Më dt.27 shkurt 2025, Komuna e Pejës ka bërë promovimin e projektit “Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”, kontratë kjo e lidhur me operatorin ekonomik “KUQI FARMS” SH.P.K më seli në fsh.Lutogllavë, KK Pejë. Ky projekt ka për qëllim trajtimin e qenëve endacak si dhe rritjen e sigurisë për qytetarët e Komunës së Pejës.

4.5 Gjatë muajit mars dhe prill 2025, ka vazhduar inspektimi i punëve tek kanalet e ujitjes në fshatrat e Komunës së Pejës, siç janë: në fshatin Çallapek si dhe përmirësimi i punëve të kryera tek kanali i ujitjes në fshatin Llugaxhi, në fshatin Dubovë dhe Trestenik si dhe tek penda në fshatin Vranoc. Projekte këto me rëndësi të veçantë për komunitetin lokal.

4.6 Më dt.07 prill 2025, Drejtoria për Bujqësi dhe Zyra për Informim Publik kanë organizuar konsultimin publik për Draft- Rregulloren për Taksa Komunale Nr.02-2025 për marrjen me qera të tokës komunale për kultura një vjeçare, për Plotësim Ndryshimin e Rregullores nr.02-2023 KPE për Taksa Komunale.

4.7 Shpërndarja e fundit e përfituesve të mekanizmit bujqësor nga bashkëpunimi mes KK Pejë dhe IRK, u realizua më dt.08 prill 2025, ku u shpërndan edhe pesë (5) makina mbjellëse të misrit, duke mbyllur kështu me sukses edhe këtë bashkëpunim.

4.8 Më dt.18 qershor 2025, u mbajt një takim i veçantë i organizuar nga EcoKosWomen (EKW) me gratë bletare, në prani të Drejtorisë për Bujqësi, Zyrës për Barazi Gjinore si dhe përfaqësuesve nga organizata partnere We Effect.

Qëllimi i takimit ishte fuqizimi i grave bletare në fushën e bletarisë përmes dialogut, bashkëpunimit dhe identifikimit të nevojave konkrete për mbështetje.

4.9 Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me KRU “Drini i Bardhë” për ndihmë të fermerëve në hapjen dhe pastrimin e kanaleve të ujitjes në vlerë totale 10,000.00 Euro.

FOTO NGA AKTIVITETET E LARTËPËRMENDURA:












5. SUBVENCIONET E MBPZHR-së (PROGRAMI I PAGESAVE DIREKTE)

6.1 Nga dt.15.01-13.02.2025, MBPZHR-ja ka shpallur thirrje për aplikim për TM2 (subvencionim për qumësht sipas cilësisë, viça për majmëri, therrje dhe akuakulturë) për vitin 2024.



6.2 Programi i Pagesave Direkte për vitin 2025

MBPZHR, nga dt.03.04.2025 deri me 02.05.2025, ka hapur afatin kohor për aplikim në Programin e Pagesave Direkte. Në kuadër të këtij programi kanë aplikuar gjithsej **1877** fermerë nga Komuna e Pejës, më të mbjellura të kulturave të ndryshme bujqësore, në sipërfaqe totale prej **9000ha**, ku më së shumti mbizotërojnë, kultura e misrit dhe grurit:

1. Kulturë misri - 5143.6ha;
2. Kulturë gruri - 2856.1ha.

Mbështetja për fermerë në Programin e Pagesave Direkte, gjithashtu përfshinë edhe:

- Sektorinë e blegtorisë,
- Sektorinë e bletarisë, si dhe
- Sektori i pemëtarisë, duke përfshirë edhe pemët e imta.

PËRMBLEDHJE:

- ✚ Për gjashtë mujorin të parë të vitit 2025, Drejtoria për Bujqësi, përmes subvencioneve ka përkrahur **172** fermerë me pajisje të ndryshme bujqësore, në mënyrë që të krijohen kushte më të mira të punës në zhvillimin e sektorit rural.
 - ✚ Llojet e mekanizmit bujqësor, janë:
 1. Freza 1.8m (60 copë);
 2. Freza 2.0m (20 copë);
 3. Spërkatëse 400 L (25 copë);
 4. Mikser për përgaditjen e ushqimit të kafshëve (5 copë);
 5. Mbjellëse e grurit 16 rendëshe (10 copë);
 6. Rotokosa 135 (10 copë);
 7. Rotokosa 165 me kardan (10 copë);
 8. Mbjellëse dy rendore e patates (4 copë);
 9. Mbjellëse 5 rendëshe e qepujkave (4 copë);
 10. Nxjerrëse e patates/qepës një rendore (4 copë);
 11. Grabuja me traka me kardan (20 copë).
 - ✚ Nga Drejtoria janë ndihmuar **1877** fermerë për përgaditjen e dokumentacionit dhe aplikimin në sistemin elektronik eFR gjatë afatit kohor të subvencioneve, të shpallura nga MBPZHR-ja, me gjithsej sipërfaqe prej **9000ha** të mbjellura me kultura të ndryshme bujqësore.
 - ✚ Totali i mjeteve financiare, subvencione nga Drejtoria e BPH-së: **247,050.00Euro**.
 - ✚ Vlera totale e kontratave të nënshkruara për investime kapitale për vitin 2024/2026: **811,907.94 € , 10 mijë metra kanal te ujitjes.**
 - ✚ Pagesat e kryera gjatë gjashtëmujorit të parë për vitin 2025 janë:
 - ✚ Pagesa nga investimet kapitale – **233,602.75** Euro, të planifikuara **550,000.00 €**
 - ✚ Realizimi **42.47** % i buxhetit.
 - ✚ Pagesa për subvencione – **154,966.96** Euro, të planifikuara **270,000.00 €**
 - ✚ Realizimi **57.40** % i buxhetit.
-



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORATI PËR BUXHET E FINANCA

RAPORTI
I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE TË REALIZUARA BUXHETORE PËR PERIUDHËN
JANAR – QERSHOR TË VITIT 2025

PEJË , KORRIK 2025

TË HYRAT VETANAKE TË REALIZUARA GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR TË VITIT 2025

Gjatë periudhës janar - qershor të vitit **2025** dinamika dhe struktura e të hyrave të realizuara vetanake shënon ecuri të ndryshme , si në raport me planifikimin për vitin **2025**, poashtu edhe në raport me realizimin gjatë periudhës krahasuese.

(në euro)

Kodi ekonomik	Emërtimi i kodit	Realizimi I - VI - 2024	Planifikimi I - XII - 2025	Realizimi I - VI - 2025	Progresi :		%
					5 / 3	5 / 4	
1	2	3	4	5	6	7	8
16019	Zyra e Kryetarit	0.00	2.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
163	(I+II+III) Administrata dhe personeli	65,111.15	171,000.00	57,577.50	88.43%	33.67%	2.01%
16319	Administrata	65,111.15	171,000.00	57,577.50	88.43%	33.67%	100.00%
	Të hyrat vetanake	65,111.15	171,000.00	57,577.50	88.43%	33.67%	100.00%
16637	Inspekcioni	49,816.70	42,000.00	53,955.00	108.31%	128.46%	0.27%
	Të hyrat vetanake	15,821.70	42,000.00	7,680.00	48.54%	18.29%	14.23%
50102	Gjobat nga gjykatat	33,995.00	0.00	46,275.00	136.12%	#DIV/0!	85.77%
17519	Buxhet e financa	1,583,311.98	3,232,177.00	1,879,708.67	118.72%	58.16%	46.89%
	Të hyrat vetanake	1,173,308.98	3,232,177.00	1,345,403.36	114.67%	41.63%	71.58%
50101	Gjobat në trafik	410,003.00	0.00	534,305.31	130.32%	#DIV/0!	28.42%
180	(I+II) Punë komunale , shërbime publike	46,255.31	70,000.00	23,699.48	51.24%	33.86%	0.83%
18019	I. Infrastruktura rrugore	46,255.31	70,000.00	23,699.48	51.24%	33.86%	100.00%
	Të hyrat vetanake	46,255.31	70,000.00	23,699.48	51.24%	33.86%	100.00%
47019	Bujqësi , pylltari , zhvillim rural	29,201.25	11,897.60	242,177.55	829.34%	2035.52%	6.69%
	Të hyrat vetanake	2,202.75	11,897.60	192,092.55	8720.58%	1614.55%	79.32%
	Participim i qytetarëve	26,998.50	0.00	50,085.00	185.51%	#DIV/0!	20.68%
48019	Zhvillim ekonomik	22,775.00	40,000.00	28,409.15	124.74%	71.02%	0.40%
	Të hyrat vetanake	22,775.00	40,000.00	11,521.00	50.59%	28.80%	40.55%
	Don. e jashtme - 49 - Eu-Unioni European	0.00	0.00	16,888.15	#DIV/0!	#DIV/0!	59.45%
650	(I+II) Gjeodezi dhe kadastrë	381,940.99	868,000.00	569,186.95	149.02%	65.57%	19.84%
65095	I. Shërbime kadastrale	189,675.00	410,000.00	103,387.00	54.51%	25.22%	18.16%
	Të hyrat vetanake	189,675.00	410,000.00	103,387.00	54.51%	25.22%	100.00%
65495	II. Çështjet pronësore - juridike	192,265.99	458,000.00	465,799.95	242.27%	101.70%	81.84%
	Të hyrat vetanake	192,265.99	458,000.00	465,799.95	242.27%	101.70%	100.00%
66100	Planifikimi urban dhe mjedisi	470,316.33	908,931.40	452,297.55	96.17%	49.76%	15.76%
	Të hyrat vetanake	470,316.33	908,931.40	452,297.55	96.17%	49.76%	100.00%
	Shëndetësia	45,592.50	109,000.00	61,564.00	135.03%	56.48%	2.15%
Definicionet.....	4
Njësitë raportuese.....	6
Përmbledhje ekzekutive.....	7
I. Vlerësimi i nivelit të rrezikut në komunën e Pejës.....	7
1.1. Identifikimi i rrezikut.....	8
1.2. Aanaliza dhe vlersimi i rrezikut.....	9
II. Trajtimi – Kontrolli dhe zbutja e rrezeikut operacional.....	13
III. Monitorimi i nivelit të rrezikut.....	17
IV. Raportimi dhe trajtimi i incidenteve.....	18

LISTA E FIGURAVE

FIGURE 1, Kontrolllet sipas efektivitetit.....	9
FIGURE 2, Niveli i Rrezikut të mbetur.....	10
FIGURE 3, Kategoria e Rrezikut.....	13
FIGURE 4, Trajtimi i rrezikut.....	14

LISTA E TABELAVE

Table 1, Rangimi i rrezikut residual.....	12
Table 2, Lista e veprimeve te propozuara.....	17

DEFINICIONET

Kontrolli i Brendshëm - nënkupton procesin që kryhet nga menaxhmenti dhe personeli i subjektit; i përcaktuar për adresimin e rreziqeve dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve në realizimin e interesit publik dhe objektivave të subjektit.

Menaxhimi Financiar Dhe Kontrolli - nënkupton sistemin e politikave, procedurave dhe aktiviteteve të cilat themelohen, mbahen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik, dhe zbatohen nga personeli, me synim të adresimit të rreziqeve dhe ofrimit të sigurisë së arsyeshme, për arritjen e objektivave të subjektit të sektorit publik;

Auditimi i Brendshëm - nënkupton aktivitetin këshillëdhënës të pavarur dhe objektiv në ofrimin e sigurisë së arsyeshme, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të subjektit të sektorit publik, e që ndihmon subjektin në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Llogaridhënia Menaxheriale - nënkupton përgjegjësinë e menaxherëve për veprimet, vendimet, rezultatet dhe politikat, duke përfshirë administrimin, qeverisjen dhe zbatimin brenda fushëveprimit të pozitës, dhe detyrimin për të raportuar, shpjeguar dhe përgjigjur në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet, kohën dhe buxhetin, ndaj organit i cili i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë;

Siguri e Arsyeshme - nënkupton nivelin e kënaqshëm të besimit, që kostoja e kontrollit nuk i tejkalon përfitimet e pritura;

Korniza për Menaxhim të Rrezikut – është një seri aktesh rregulluese dhe komponentësh, që sigurojnë themelet dhe aranzhimet organizative për planifikimin, zbatimin, monitorimin, rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të rrezikut në subjekt.

Menaxhimi i Rrezikut është proces i përgjithshëm i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve dhe zbatimit të kontroleve të nevojshme për të mbajtur ekspozimin ndaj rrezikut në një nivel të pranueshëm. Kjo duhet të integrohet si pjesë e procesit të përgjithshëm të menaxhimit.

Rreziku - reflekton pasigurinë drejt arritjes së objektivave të subjektit. Ekspozimi ndaj rrezikut është kombinimi i probabilitetit (gjasës që do të ndodhë një ngjarje) dhe ndikimit të ngjarjes nëse kjo ndodhë.

Apetiti ndaj Rrezikut – Niveli i rrezikut të cilin subjekti është i gatshëm ta pranoj në mënyrë që të arrij objektivat e veta.

Toleranca e Rrezikut - është niveli i pranueshëm i variacionit në lidhje me arritjen e objektivave;

Ndikimi – nënkupton efektin e një ngjarje jo të favorshme që do të ketë për arritjen e objektivave, nëse ngjarja ndodhë.

Probabiliteti i Shfaqjes – nënkupton probabilitetin e një ngjarje të pafavorshme që do të ndodhë, në qoftë se nuk ka pasur aktivitete të kontrollit apo aktivitetet e kontrollit janë të pamjaftueshme.

Incident – Një ngjarje rreziku që ka ndodh.

Rreziku I Qenësishëm (Inheret) – Niveli i rrezikut në mungesë të kontrolleve.

Rreziku i Mbetur (Residual) – Niveli i rrezikut pas implementimit të kontrolleve.

Maturimi i Proceseve te Rrezikut - Aftësia e institucionit për të menaxhuar rreziqet. Aftësia vlerësohet për disa fusha: kultura e riskut, qeverisja e riskut, proceset e menaxhimit të riskut dhe kompetenca institucionale [aftësitë, njohuri, përvojë.

Pronar i Rrezikut - Personi përgjegjës për menaxhimin e një rreziku të caktuar të lidhur me objektivin(et) që ai/ajo është përgjegjës.

Efikasiteti - nënkupton raportin ndërmjet burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës;

Efektiviteti - nënkupton masat në të cilën objektivat e një subjekti, procesi apo aktiviteti realizohen si një marrëdhënie ndërmjet arritjeve të planifikuara dhe aktuale; dhe

Toleranca e Rrezikut - është niveli i pranueshëm i variacionit në lidhje me arritjen e objektivave;

Ndikimi – nënkupton efektin e një ngjarje jo të favorshme që do të ketë për arritjen e objektivave, nëse ngjarja ndodhë.

Probabiliteti i Shfaqjes – nënkupton probabilitetin e një ngjarje të pafavorshme që do të ndodhë, në qoftë se nuk ka pasur aktivitete të kontrollit apo aktivitetet e kontrollit janë të pamjaftueshme.

NJËSITË RAPORTUESE

Komuna e Pejës në strukturën e saj organizative definon qartë linjat organizative dhe raportuese. Të gjitha njësitë organizative raportojnë te linja e tyre hierarkike duke lehtësuar ambientin komunikues, raportues dhe të llogaridhënies.

Më poshtë gjeni të listuar njësitë organizative (10 gjithsej) sipas linjave hierarkike, të cilat janë subjekt i vlerësimit të rrezikut sipas Rregullës së Brendshme për Menaxhimin e Rrezikut.

1. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
2. Drejtoria për Shërbime Publike
3. Drejtoria për Ceshtje Pronesore -Juridike
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
5. Drejtoria e Arsimit
6. Drejtoria e Bujqësisë
7. Njësia për Prokurim
8. Drejtoria e Urbanizimit
9. Drejtoria e Inspektoriatit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i Menaxhimi të Rrezikut për vitin 2025 ofron një pasqyrë të gjithëpërfshirëse të rreziqeve të identifikuar dhe vlerësuara nga njësitë organizative në Komunën e Pejës.

Raporti është dizajnuar në atë mënyrë që të përshkruajë strategjitë e menaxhimit të rrezikut të përdorura nga Komuna e Pejës, duke u fokusuar në identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve që mund të ndikojnë në operacionet e komunës dhe mirëqenien e komunitetit.

Menaxhimi i rrezikut ka një rëndësi kritike për Komunën e Pejës duke pasqyruar rolin e Komunës në ofrimin e shërbimeve publike, ruajtjen e mirëqenies së qytetarëve dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i kornizës dhe funksionit për menaxhim të rrezikut brenda Komunës është që në mënyrë sistematike të identifikoj, vlerësoj, reduktoj dhe monitoroj rreziqet të cilat mund të afektojnë arritjen e objektivave dhe ofrimin e shërbimeve.

Menaxhimi efektiv i rrezikut ndihmon në mirëmbajtjen e ofrimit të shërbimeve në vazhdimësi (pa ndërprerje), edhe në raste të rrethanave të jashtëzakonshme. Vlerësimi i rrezikut mbështet alokimin efektiv të resurseve, ku me prioritetizimin e rreziqeve bazuar në mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin që ato rreziqe mund të kenë, Komuna mund të ndaj fonde dhe të marr veprime aty ku duhen më së shumti.

I. VLERËSIMI I NIVELIT TË RREZIKUT NË KOMUNËN E PEJES

Bazuar në Rregullen e Brendshme për Menaxhim të Rrezikut është adaptuar metodologjia për identifikim dhe vlerësim të rrezikut në komunë. Me konsolidim të këtyre rreziqeve dhe analizës së pavarur nga Koordinatori i Menaxhimi të Rrezikut është bërë përpjekje që të fokusohet tek rreziqet më të larta dhe të bëhet prioritetizimi i tyre varësisht nga ajo se sa këto rreziqe ekspozojnë proceset kritike dhe objektivat taktike dhe strategjike të komunës.

Për këtë qëllim është përcjell Rregulla e Brendshme për Menaxhim të Rrezikut dhe është zhvilluar komunikim dhe bashkëpunim i ngushtë me njësitë organizative në mënyrë që të merret raporti individual nga njesia organizative lidhur me vlerësimin, gjasën dhe ndikimin që potencialisht një ngjarje e caktuar të vlistë në ndikimin në realizimin e objektivave të institucionit.

Për nivelin e rrezikut për secilën objektive dhe procese të punës, Koordinatori për Menaxhim të Rrezikut dhe bartësit e rrezikut janë pajtuar me nivelin e vetvetishëm të rrezikut, përshtatshmërinë e nivelit të kontrollit të brendshëm për të zbutur rrezikun, si dhe rrezikun e mbetur.

1.1. IDENTIFIKIMI I RREZIKUT

Procesi i menaxhimit të rrezikut fillon me identifikimin e rrezikut si një veprim sistematik që ka për qëllim të identifikoj dhe dokumentoj rreziqet kryesore të cilave u ekspozohet subjekti. Kjo fazë ka mundësuar gjenerimin Regjistrin të Rrezikut i cili përmban një listë të të gjitha ngjarjeve të rrezikut të cilat mund të vonojnë apo edhe parandalojnë arritjen e objektivave strategjike të subjektit.

Regjistri i Rrezikut i cili aktualisht përmban 25 rreziqe të identifikuar dhe vlerësuara.

Identifikimi i rreziqeve është bërë përmes instrumenteve për identifikim sipas tabelës së Regjistrin të Rrezikut si:


- Numri identifikues për secilin rrezik (Secilit rrezik ti vendoset një numër identifikues në mënyrë që evidenca dhe gjurmimi të jetë më i lehtë)
- Kategoria e rrezikut - Strategjike, Operative, Financiare dhe Pajtueshmërisë;
- Cilën objektivë të subjektit e ndikon ky rrezik;
- Cilin proces të punës shoqëron ky rrezik;
- Çka e shkakton këtë ngjarje rreziku? (Shkas, rrethanë, pasiguri) e cila mund të rrit mundësinë që ngjarja e rrezikut të ndodh? Mund të jenë disa shkaktar të cilët mund të bëjnë që një ngjarje rreziku të ndodh;
- Si ndikon kjo ngjarje rreziku në arritje e objektivave/ apo mbarëvajtjen e procesit të punës;
- Takimet dhe diskutimet me njësitë organizative; dhe
- Si referencë është marr edhe lista e rreziqeve e përpiluar në Maj 2025 .

1.2. ANALIZA DHE VLERËSIMI I RËZIKUT

Në matricen e Rrezikut pjesa e vlerësimit, për secilën ngjarje rreziku të identifikuar është kryer vlerësimi:

- Kalkulimi kuantitativ i gjasës dhe ndikimit sipas matricës, që ngjarja e rrezikut mundet me pas;
- Nivelit të rrezikut të vetëvetishëm (inherent);
- Efektiviteti i kontrolleve; dhe
- Niveli i rrezikut të mbetur (residual).

Sipas matjes së efektivitetit të kontrolleve janë përcaktuar tri klasa si: kontrolle **efektive**, të **forta**, të **duhura**, **duhen përmirësuar** dhe **asnjë**. Gjithsej nga total 25 rreziqet e paraqitura për efektivitetin e kontrollit, 1 kontrolle janë efektive, 1 janë të duhura, 4 të forta si dhe 18 duhet përmirësuar dhe me 1 ka rezultuar asnjë kontroll. Shih grafikun më poshtë:



Figurë 1, Kontrollat sipas efektivitetit

Nga to janë vlerësuar: 3 Rreziqe **EKSTREM**, 3 Rreziqe të **ULËT**, dhe 10 Rreziqe **TË LARTË**, 5 Rreziqe të **MESME**, 4 të **MODERUAR**




Figura 2, Niveli i rrezikut të mbetur

Niveli i rrezikut të mbetur (rezidual) - niveleve të vlerësimit të rrezikut inherent të procesit të evidentuar, me nivelin e efektivitetit të kontrolleve për çdo rrezik, ka rezultuar në vlerësimin e nivelit të rrezikut operacional të mbetur (residual). Pas filtrimit të të dhënave dhe agregimit të tyre, gjatë kësaj periudhe janë identifikuar 25 rreziqe aktive.

Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe punë Komunale		
1. Mos realizimi i planifikimit buxhetor		I LARTË
2. Mos fillimi i punimeve		I LARTË
3. Vonesa në kryerje të punimeve nga operatorët		I LARTË
4. Mos finalizimi i punimeve sipas planit dinamik		I LARTË
5. Mos pagesa e punëve të kryera në kohë		I LARTË
Drejtoria për Arsim		
1. Marrja e mjeteve financiare të Drejtorië së Arsimit për shkak të padive të stafit arsimor		EKSTREM
2. Mungesa e kuadrove të kualifikuar në lëndët deficitare		I LARTË
3. Mbyllja e shkollave si pasojë e uljes së nr. Të nxënësve		EKSTREM
4. Ndërprerja e marrëdhënies së punës nga ana e mësimdhënësve pa paralajmërim		I LARTË
5. Braktisja e shkollës nga nxënësit		I LARTE
Drejtoria për Buxhet dhe Financa		
Keqklasifikimi i pagesave (Vendimet gjyqësore) EKSTREM		

Vonesa në pagesën e faturave

I LARTE

Drejtoria për Buxhet dhe Financa – Tatimi në Pronë

- | | |
|--|---------|
| 1. Pamundësia e arkëtimit të borxheve nga tatimi në pronë | I LARTË |
| 2. Vonesa në afatet e shqyrtimit të ankesave nga tatimi në pronë | I ULËT |

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

- | | |
|--|---------|
| 1. Mos përmbushja e kërkesave karshi palëve, për përballimin e shpenzimeve
financiare | I LARTË |
| 2. Siguria në Qps | I ULËT |

Drejtoria për Ceshtje Pronesore-Juridike

- | | |
|---|---------|
| 1. Kthimin e pronave më shfrytëzim të përkohshëm në shfrytëzim të komunës | I LARTË |
| 2. Uzurpimi i pronës komunale nga Kioskat | I LARTË |

Zyra për Prokurim

- | | |
|---|---------|
| 1. Zbatimi i procedurave të negociuara të prokurimit | I LARTË |
| 2. Inicimi i aktiviteteve me vonese dhe nevoja për shkurtim të afatit për ofertim | I LARTË |
| 3. Vonesat në vlerësim dhe vlerësimi jo adekuat | I LARTË |

Drejtoria e Inspeksionit

- | | |
|---------------------------|---------|
| 1. Inspektimi i ndertimev | I LARTE |
|---------------------------|---------|

Drejtoria e Urbanizimit

1. Zbatimi i planeve dhe lejeve ndërtimore

I MESEM

Drejtoria e Bujqësis


-Problemet pronësore në relizimin e investimeve kapitale(Kanalet e ujitjes)

Table 1, Rangimi I Rrezikut Residual

Rreziku duhet të vlerësohet bazuar në mundësinë e ndodhjes dhe ndikimit që ajo ngjarje mundet me pas në objektivat e subjektit. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik siguron që objektivat e subjektit të jenë të vendosura në planet strategjike dhe vjetore, dhe të dokumentuara sipas kategorive, si në vijim:

- Strategjike - bazuar në planet strategjike të subjektit;
- Operative - bazuar në planet e veprimit të subjektit;
- Financiare - bazuar në kornizën afatmesme të shpenzimeve, në ligjin vjetor të buxhetit si dhe aktet nënligjore të aplikueshme financiare; dhe
- Pajtueshmërisë - bazuar në kornizën e aplikueshme ligjore¹.

Pas analizave nga 25 përshkrimet e rreziqeve, ka dal kjo statistikë si me poshtë:



Figurë 3, Kategoria e Rrezikut

II. TRAJTIMI – KONTROLLI DHE ZBUTJA E RREZIKUT OPERACIONAL

Bazuar në Procedurën Standarde të Operimit për Menaxhimin e Rrezikut, vlerësimi i rrezikut duhet të rezultojë me vendime për të trajtuar rrezikun, varësisht nga hierarkia e nivelit të rrezikut. Trajtimi i rreziqeve madhore ka për synim të zvogëlojë rrezikun brenda nivelit të tolerancës së pranueshme. Për këtë periudhë janë dhënë veprimet për trajtim të rreziqeve të vlerësuara si:

Përgjigja ndaj rrezikut ka të bëjë me zhvillimin e strategjive për reduktim ose eliminim të kërcënimeve dhe ngjarjeve të rrezikut. Përgjigjet ndaj rrezikut përfshijnë identifikimin dhe vlerësimin e një rangu të opsioneve të mundshme për të adresuar dhe implementim opsionet e përzgjedhura. Menaxhmenti duhet të zhvillojë strategji për t'ju përgjigjur të gjitha rreziqeve materiale, prioritetizoj rreziqet që i afrohen apo tejkalojnë apetitin e rrezikut. Strategjitë për përgjigje ndaj rrezikut duhet të dokumentohen së bashku me përgjegjësitë dhe afatet për implementim.

Pasi të kemi përgatitur profilin e rrezikut, sipas hapave të mësipërm, udhëheqësi i SSP-së duhet të marrë në konsideratë se si të reagojë ndaj secilit rrezik, duke ndërmarrë veprime për lehtësimin e rrezikut. Ekzistojnë 4 kategori² të veprimeve për lehtësimin e rrezikut, prej të cilave udhëheqësi i SSP-së përzgjedh përgjigjen më efektive.

- 1) Trajtimi deri në kufizim ose reduktim të rrezikut - Zyrtari Kryesor Administrativ i subjektit të sektorit publik, ka përgjegjësi të qartë për të zbatuar kontrollet e brendshme që të menaxhojë rreziqet që burojnë në kuadër të organizatës së tyre.
- 2) Ndërprerja e rrezikut - Ndërprerja e rrezikut realizohet me reduktimin ose kufizimin e disa aktiviteteve.
- 3) Transferimi i rrezikut - Rreziku mund të transferohet te pala e tretë, me anë të blerjes së sigurimit ose mjeteve të tjera kontraktuale, që përcaktojnë se pala e tretë do të mbulojë çfarëdo pasoje të pafavorshme të materializimit të rrezikut.
- 4) Tolerimi i rrezikut - Mund të mos jetë e mundshme që të gjinden mjete me kosto efektive për të lehtësuar rreziqet e caktuara, në veçanti rreziqet me shkallë të ulët që nuk kanë ndikim të madh në kapacitetin operativ. Në këtë rast, udhëheqësi i SSP-së mund të zgjedhë që të pranojë rrezikun, ndoshta të lërë anash disa rezerva financiare për të mbuluar çfarëdo humbje.

Për këtë periudhë raportimi janë zhvilluar veprime për trajtim të rrezikut si më poshtë.



FIGURE 4, TRAJTIMI I RREZIKUT

Nga grafiku me lartë shihet se të gjitha veprimet e propozuara për trajtim të rrezikut janë të reduktoj rrezikun në nivelin e pranueshëm si dhe të ndërprejn rrezikun, brenda nivelit të apetiti të rrezikut.

DREJTORIA PËR ARSIM

1. Përcjellja e afateve ligjore me kohë për shkak që ekziston rreziku për shkak të mos përmbajtës së afatit, pala mund ta fitoj lëndën automatikisht edhe nëse nuk e ka atë të drejtë

2. Trajtim për planifikim vjetor për ndarje të buxhetit lidhur me lëndët gjyqësore nuk mund të parashikohen.
3. DKA përmes menaxherve të kontratave monitorim dhe respektimi tyre
4. Duke planifikuar sistemimin e mësimdhënësve që janë të rrezikuar të mbesin pa normativin e fondit të orëve si pasojë e ramjes së numrit të nxënësve.
5. Sigurimi i mësimdhënësve adekuat sipas lëndëve deficitare
6. Vetëdijesimi, Informimi për mësimdhënësit lidhur me procedurat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës
7. Hartimi i planit komunal kundër braktisjes

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

1. ZKA- KK duhet të bëjë një planifikim më të mirë të pagesave
2. ZKA - KK pagesat të kryhen në kategorinë ekonomike adekuate
3. Komunikimi në nivelin qendror (Ministritë e linjës)
4. Vendim në Asamble Komunale për rritje buxhetore,
5. ZKA- KK duhet të bëjë një planifikim më të mirë të Investimeve Kapitale,
6. Programet Buxhetore duhet të kenë draft projekt të perpiluar me korrektesi,
7. Prokurimi - të harmonizohet me planin e Investimeve Kapitale dhe kohën e inicimit të procedurave,
8. Të dizajnohet një plan kontrolli për menaxherët e kontratave, të japin llogaridhënie për ecurinë e investimeve kapitale.

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA – TATIMI NË PRONË

1. Plan real të rianketimit të pronave,
2. Monitorimi i rianketuesve në teren.
3. Kordinimi i obliguar me drejtoritë komunale përkatëse për identifikimin e objekteve të reja. (informata e lejeve të ndërtimit; lejeve të shfrytëzimit të pronës; dhe të ngjashme),
4. Kordinim me agjencinë e kadastrës për qasje në të dhëna.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

1. Koordinim me Drejtorin për Buxhet dhe financa për planifikim të fondeve të kategorisë ekonomike dhe subvencioneve.
2. Të zbatohet Pakoja Themelore e kujdesit paliativ për KPSH dhe cila përbëhet nga: barnat esenciale, pajisjet mjekësore etj.
3. Përmirësim i politikave shëndetësore.
4. Zbatimi dhe shpërndarja e Listës së barnave nga lista esenciale
5. Harmonizmi i brendshëm për implementim të projekteve,
6. Përsheptimi i procedurave të prokurimit,
7. Planifikimi i mirëfilltë i hartimit të projekteve.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE PUNË KOMUNALE

1. Hartimi i një plani strategjik për investime kapitale në përputhje me prioritetet dhe politikat afatgjate të qeverisë
2. Aprovimi i projekteve në bazë të dëshmive të mjaftueshme për ndërlidhjen e tyre me qëllimet dhe objektivat afatgjate të qeverisë
3. Plan më i mirë kohor i prokurimit dhe menaxhimit të projekteve
4. Zhvillimi i procedurave të prokurimit në përputhje me ligjin dhe vlerësimi i ofertave sipas kushteve dhe kriterëve të shpallura në dosje të tenderit
5. Intensifikimi i punëve të KEK në vendosjen e instalimeve të reja të rrjetit të ndriqimit për të ulur nevojat e shpeshta për mirëmbajtje
6. Duhet paraprë mjetë për mirëmbajtjen e gjithë teritorit të Komunës

ZYRA PËR PROKURIM

1. Zbatimi i Planit vjetor të prokurimit me kohë (projekteve për shërbime të rregullta_kontrata kornizë)
2. Monitorimi i ekzekutimit të kontratave me afate kohore nga drejtori i njësisë kërkuese

DREJTORIA E MIRËQENJES SOCIALE

1. Rritja e Sigurisë në Qps
2. Angazhimi i stafit profesional për siguri
3. Infrastruktura adekuate

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

1. Rritja e numrit të inspektorve të ndertimit
2. Angazhimi i përkoshem i inxhinierve

DREJTORIA E URBANIZMIT

1. Zhvillimi i procedures per legalizim
2. Shqyrtimi i kerkesave per leje ndertime

DREJTORIA E BUJQESIS

- Komunikimi i vazhdushem me pale per te zgjidhur problemet pronesore
- Inicimi i procedurave pasi paraprakisht jane evituar ne kadaster te gjitha problemet pronesore

Tabela 2, Lista e veprimeve te propozuara

III. MONITORIMI I NIVELIT TË RREZIKUT

Përmes dizajnit dhe monitorimit të indikatorëve kyç të rrezikut subjekti sigurohet se rreziqet kritike nuk rriten mbi nivelin e pranueshëm (rreziqet me nivel më të lartë se apetiti i rrezikut) dhe për t'u siguruar se përgjigjet ndaj rrezikut (kontrollet e brendshme) janë efektive dhe operojnë ashtu siç kërkohet. Kjo arrihet përmes indikatorëve kyç të rrezikut për të gjitha rreziqet kritike.

Indikatorët kyç të rrezikut, matës të cilët janë të lidhur me rrezik specifik, ofrojnë indikacion se kontrollet e implementuara funksionojnë ashtu siç kërkohet. Indikatorët mund të jenë parashikues të ngjarjeve të rëndësishme ose rreziqeve të cilat mund të kenë ndikim negativ në subjekt.

Për periudhat në vijim do të zhvillohet Katalogu i Indikatorëve Kyç të Rrezikut dhe monitorohet

IV. RAPORTIMI DHE TRAJTIMI I INCIDENTEVE

Deri në vitin 2023 ka pasur raportim të rregullt për Menaxhim të Rrezikut (MR), mirepo vetëm përpilim të listës së rreziqeve në fund të vitit.

Me mbështetje të Projektit USAID KMI i cili ka draftuar Rregullen për Menaxhimin e Rrezikut dhe ka zhvilluar metodologjinë për vlersimin të rrezikut si dhe trajnimeve të ofruara për stafin e komunës së Pejës. Kryetari i komunës ka aprovuar Rregullen për Menaxhim të Rrezikut e cila i obligon të gjitha njësitë organizative të komunës së Pejës të bëjnë vlersim dhe raportim të rregullt të MR. Raportimi për MRR bëhet në baza tremujore ndersa raportimi i incidenteve bëhet menjehere.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024 ka filluar raportimi individual i njësive organizatave të Kordinatori i MR, mirepo nuk kanë raportuar të gjitha njësitë organizativet të komunës prandaj edhe raporti nuk është i plotë. Kordinatori i MR ka pranuar raportet nga keto drejtorit për financa, çështje pronësore-juridike, shërbimeve publike, shëndetësis, prokurimi, arsimit, bujqësia, mirëqenjen sociale, urbanizmit dhe në keto drejtori nuk ka pranuar raporte për menaxhim të rrezikut e ato janë Kultur, Rini dhe sport, drejtoria e Kadastres dhe gjeodezis, zyra për komunitete drejtoria e zhvillimit ekonomik .Pas mbledhjes së informatave nga raportet individuale të pranuar nga njësitë organizative të komunës së Pejës kordinatori për MR i paraqet kryetarit raport të konsoliduar të MR-së për tremujorin e dytë të vitit 2025 menaxhimit të rrezikut, dhe se tash e tutje bazuar në Rregullen për Menaxhim të Rrezikut do të ketë raportim të rregullt në baza tremujore.

Me respekt,

Egzon Kastrati

Koordinator për Menaxhim të Rrezikut

Komuna e Pejës





RAPORT GJASHTËMUJOR

Periudha: Janar – Qershor 2025

Zyra për Barazi Gjinore, Komuna Pejë

Përgatitur nga: Samka Drançolli

Drejtuar: Kryetarit, Gazmend Muhaxheri

Data: 19.06.2025

1. Përmbledhje e Përgjithshme

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës ka realizuar një sërë aktivitete dhe trajnimesh të fokusuar në promovimin e barazisë gjinore, fuqizimin e grave dhe përfshirjen e komunitetit në zhvillimin lokal. Aktivitetet janë zhvilluar në bashkëpunim me partnerë institucionalë dhe organizata ndërkombëtare, duke përfshirë IOM UN Migration dhe UN Women Kosovë.

2. Aktivitetet Kryesore të Realizuara

2.1. Aktivitet për Ditën Ndërkombëtare të Gruas (8 Mars 2025)

- **Eventi i Nderimit për Punonjëset e Komunës**
 - Data: 8 mars 2025
 - Vendi: Restaurant Era
 - Pjesëmarrës: 65 persona
 - Përshkrim: Organizim aktiviteti simbolik për nderimin e grave në administratën komunale, duke falënderuar për kontributin dhe përkushtimin e tyre në shërbimet publike dhe zhvillimin e komunitetit.
- **Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas**
 - Data: 10 mars 2025
 - Vendi: Shtëpia e të Moshuarve dhe Galeria e Arteve
 - Pjesëmarrës: 10 biznese të grave dhe 120 pjesëmarrës (rreth 70 gra dhe 50 burra)
 - Përshkrim: Organizimi i panairit të grave sipërmarrëse, ekspozitave artistike dhe sesioneve interaktive me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave.

2.2. Trajnime për Ngritjen e Kapaciteteve të Zyrtarëve Komunalë

- **Trajnimi “Integrimi gjinor dhe vlerësimi i ndikimit gjinor”**
 - Data: 18 nëntor 2024

- Vendi: Hotel Dukagjini
- Pjesëmarrës: 16 persona (12 gra, 4 burra)
- Përshkrim: Trajnim për avancimin e njohurive dhe kapaciteteve për integrimin gjinor dhe metodologjinë e vlerësimit të ndikimit gjinor në politikat publike.
- **Trajnimi “Buxheti i përgjegjshëm gjinor si mjet për avancimin e barazisë gjinore”**
 - Data: 16 dhjetor 2024
 - Vendi: Hotel Dukagjini
 - Pjesëmarrës: 21 persona (17 gra, 4 burra)
 - Përshkrim: Forcimi i kapaciteteve të stafit komunal për integrimin e perspektivës gjinore në proceset buxhetore dhe planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore.

2.3. Aktiviteti për Ditën Botërore të Sindromës Down

- Data: 21.03.2025
- Pjesëmarrës: Rreth 200 persona, përfshirë gra, burra, vajza dhe djem
- Përshkrim: Organizim i aktiviteteve të ndryshme për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e fëmijëve me Sindromën Down në komunitet, me përfshirjen e shkollave, kopshtit, OJQ-ve dhe donatorëve lokalë.

3. Rezultatet dhe Ndikimi

- Rritja e ndërgjegjëimit për barazinë gjinore dhe përfshirjen në nivel lokal.
- Promovimi i rolit dhe kontributit të grave në administratë dhe biznes.
- Fuqizimi i grave sipërmarrëse dhe promovimi i bizneseve të tyre.
- Përmirësimi i kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për integrimin gjinor në politika dhe buxhetim.
- Përfshirja e fëmijëve me Sindromën Down në aktivitete sociale, duke rritur përfshirjen dhe diversitetin në komunitet.
- Bashkëpunim i suksesshëm ndërinstitucional dhe me organizatat lokale dhe ndërkombëtare.

4. Sfidat e Hasura

- Nevoja për zgjatjen e trajnimeve dhe aktiviteteve për një numër më të madh të pjesëmarrësve.
 - Kufizime në burimet dhe kapacitetet për realizimin e aktiviteteve më të gjera në teren.
 - Sfidat në promovimin e mëtejshëm të barazisë gjinore në disa segmente të komunitetit.
-

5. Rekomandime

- Zgjerimi i aktiviteteve dhe trajnimeve përfshirëse edhe në rajone të tjera të komunës.
 - Organizimi i trajnimeve për mësuesit, prindërit dhe aktorët lokalë për përkrahjen e grupeve vulnerabël si fëmijët me Sindromën Down.
 - Përforsimi i bashkëpunimit me sektorin privat dhe OJQ-të për aktivitete të përbashkëta.
 - Krijimi i programeve të qëndrueshme për ndërgjegjësim dhe edukim mbi barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.
-

6. Planet për Periudhën Korrik – Dhjetor 2025

- Vazhdimi i organizimit të aktiviteteve simbolike dhe edukative për barazinë gjinore.
- Zbatimi i projekteve për avancimin e barazisë gjinore në politikëbërje dhe buxhetim.
- Rritja e përfshirjes së komunitetit në aktivitete sociale për diversitet dhe përfshirje.
- Intensifikimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërsektorial.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

NJËSIA E INFORMIMIT PUBLIK

Nr.01 zyrtarisht

Data:11.07.2025

Arianit.demaj@rks-gov.net

zip-peje@hotmail.com

<http://kk.rks-gov.net/peje>

Për: Kryetarin e Komunës – Ing.Gazmend Muhaxheri

CC: Kastriot Belegu

Nga: Njësia e Informimit Publik në Pejë

Lënda: RAPORTI I PUNËS JANAR – QERSHOR - 2025

Njësia e Informimit Publik e Komunës së Pejës, më punën e vet më mediat dhe më opinionin publik angazhohet që të siguroi transparencën dhe kështu ta njoftoi opinionin më punën, efikasitetin dhe angazhimet e pushtetit lokal, që do të thotë inkurajimin e qytetarëve në vendimmarrje.

Njësia e Informimit Publik, e cila si angazhim primar ka përcjelljen e punës dhe të aktiviteteve të Zyrës së Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal (legjislativ) përkatësisht Këshillit të Drejtorëve dhe organeve të tyre gjatë këtij viti, që të kryejë më sukses funksionin e vetë si një zyrë efikase. Në këtë frymë kemi bërë përpjekje që të japim kontributin tonë në afirmimin dhe prezantimin e vendimeve të Kryetarit të Komunës, të Asamblesë dhe të Shërbimit Civil Komunal dhe zbatimin e tyre në favor të mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

Njësia e Informimit Publik gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 pos punëve të zakonshme (rutine) vazhdimisht ka bërë azhurnim e Web-faqes me të dhënat më karakteristike për Komunën e Pejës, siç janë:

1. Njoftimet, raportet, takimet dhe vendimet nga Zyra e Kryetarit, Kuvendi dhe organet e tij,
2. Të dhënat e Drejtorive, rregulloret, vendimet, procesverbalet, njoftimet për kontrata dhe për dhënie të kontratës, planet vjetore të Prokurimit, konkurset, raportet vjetore, raportet financiare dhe të gjitha materialet e nevojshme në mënyrë që të sigurojmë transparencën e duhur të Qeverisë komunale, Kuvendit Komunal dhe organeve të tij.
3. Njësia e Informimit Publik gjatë periudhës janar – Qershor 2025 ka pasur bashkëpunim më të afërt me Drejtorët e drejtorive dhe organet tjera të Komunës

duket e prezantuar punën dhe aktivitetet e tyre si dhe publikimin ne web-faqe dhe rrjete sociale te Komunës

4. Stafi i zyrës ka bërë me kohë njoftimet për opinionin, nëpërmjet shpalljeve publike, web-faqes zyrtare, rrjeteve sociale, komunikatave e njoftimeve për media, për të gjitha aktivitetet zyrtare të Komunës dhe bashkëpunëtorëve të saj.
5. Gjatë periudhës Janar - Qershor 2025 kemi përgatitur dhe publikuar 118 njoftime dhe lajme për aktivitete te ndryshme.
6. Kemi publikuar Planin e Punës se Kryetarit të Komunës 2025,Planin e Punës se Kuvendit dhe kalendarin e takimeve te Kuvendit për 2025.
7. Njësia e Informimit Publik ka përgatitur Rregulloren për Transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë 2025-2029.
8. Stafi i Njesisë se Informimit ka përcjellë dhe ka përgatitur njoftimet për mbledhjet dhe aktivitetet e Asamblesë Komunale:
 - Janë mbajtur 5 Seanca të rregullta dhe 2 Solemne, janë transmetuar Live dhe janë publikuar Procesverbalet.
 - Takimet e Komiteteve te rregullta: të KPF-ca 5 takime,te Komitetit për Komunitete 5 takime, takimet e Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit 5 takime,si dhe disa takime te Komisioneve të Kuvendit.
9. Takimet Publike të Kryetarit, ne këtë përdhë është mbajtur një Takim Publik.
- 10.Është thirrur dhe organizuar Konsultimi Publik me qytetarë për KAB.
- 11.Është përgatitur dhe është publikuar kalendari i Dëgjimeve Buxhetore 2026.
- 12.Janë organizuar dhe mbajtur 7 Konsultime Publike.
- 13.Janë publikuar ne web-faqe zyrtare 73 Vendime.
- 14.Janë publikuar ne web-faqe zyrtare 81 aktivitete të Prokurimit.
- 15.Janë publikuar ne web-faqe zyrtare 22 shpallje për Konkurse të ndryshme.
- 16.Njësia e Informimit ka mbajtur kontakte të rregullta dhe kolegiale më përfaqësuesit e mediave lokale e nacionale që veprojnë ne Pejë e në vend.
- 17.Njësia e Informimit ka mbajtur kontaktet dhe bashkëpunimin e rregullt më Zyrat e Informimit Publik të Komunave të rajonit e të vendit.
- 18.Njësia e Informimit Publik ka ruajtur bashkëpunimin e rregullt me MAPL,ZIK dhe me zyrat tjera te Ministrive si dhe ka përgatitur raportet e rregullta ne MAPL.
- 19.Njësia e Informimit gjatë periudhës janar – Qershor 2025 kemi marrë pjesë në seminare informuese, në takime profesionale dhe trajnuese për mediat dhe Informimin Publik të organizuara nga MAPL,ZIK,OJQ,DEMOS,OSBE nga ekspert vendor e ndërkombëtar dhe angazhime ne punë të tjera që kanë qenë të nevojshme e të arsyeshme.

20. Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025 vazhdojmë ti kryejmë edhe shumë aktivitete obliguese si:

- Kemi përgatitur Procesverbalet e disa takimeve sipas kërkesës së kryetarit me vendim paraprak.
- Kemi krijuar në web-faqe të Komunës me qindra faqe si meny, nën-meny dhe faqe të ndryshme që janë kritere të Transparencës dhe llogaridhënies për qytetarët.
- Si rezultat i kësaj pune kemi arritur shikueshmërinë më të lartë të faqes, si dhe me mijëra dokumente të ndryshme të shkarkuara nga qytetarët.
- Kurse krahas web-faqes kemi mbajtur edhe rrjetet sociale si faqe të Komunës në Facebook-Komuna e Pejës:

Faqja e Facebook Komuna e Pejës në periudhën Janar-Qershor 2025 i ka këto statistika:

- 953257 shikime
- 24294 ndërveprime
- 63378 angazhime
- 2100 ndjekës

Njësia e Informimit Publik në Pejë vazhdon ta ketë një staf të rregullt prej tre vetave:

Arianit Demaj –Udhëheqës i Njesisë së Informimit Publik

Ariana Lukaj - Zyrtare për Informim dhe komunikim me media

Granit Thaqi - web-master, fotograf dhe menaxhues i rrjeteve sociale

Njësia e Informimit Publik
Arianit Demaj-Udhëheqës i zyrës

Opštinska Kancelarija za Zajednice i Povratak Sabahudi Cirikovic sabahudin.cirikoviq@rks-gov.net 045 724 000		 KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEĆ MUNICIPALITY OF PEJA	PERIOD RAPORTIRANJA JAN - JUNI DATUM: 26.06.2025
--	--	--	---

BR.	Opis poslova i radnih obaveza za period januar - jun 2025	Mesec realizacije	Planirana cena u eurima
1	Svakodnevno praćenje online sistema MUP-a o repatriranim licima u 08:00 i 14:00 časova. Sektor za Reintegraciju i prava zajednica je primio preko online sistema 3 slučaja repatrijacije.	Januar- Jun	
2	Svakodnevno praćenje Intraneta (Elektronski sistem)- u ovom periodu nije bilo zahteva.	Januar- Jun	
3	Saradnja sa Centralnim nivoom MUP-om kao i sa regionalnom kancelarijom MUP-a za proces repatrijacije - Saradnja (konsultacije) sa regionalnim koordinatorom kancelarije MUP-a, vezano za verifikaciju na terenu u roku od 5 dana repatriranih osoba prema uredbi br. 22/2020 za reintegraciju vraćenih osoba i za upravljanje programom za reintegraciju. - Saradnja sa MUP-om, sektor za regionalno menadžiranje slučajeva, vezano za verifikaciju podataka repatriranih slučajeva kao i dopunu podatakara istih u online ssitemu. - Radionica za jačanje kapaciteta članova KKR-ova, organizovana od strane Ministarstva unutrašnjih poslova / Odeljenja za reintegraciju povratnika i integraciju stranaca, uz podršku GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. - Ministarstvo unutrašnjih poslova održalo je radionicu na temu „Prava izbeglica na Kosovu i odgovornosti opština“, koju je podržala Kancelarija Šefa Misije UNHCR-a u Prištini, a cilj je bio podsticanje međuinstitucionalne saradnje i razmena iskustava za unapređenje pristupa pravima i uslugama za izbeglice i osobe sa međunarodnom zaštitom, sa fokusom na ulogu opština u procesu integracije. - Ministarstvo unutrašnjih poslova omogućilo je registraciju građana koji do sada nisu bili registrovani i zbog toga nemaju lične dokumente Republike Kosovo. Ova odluka pokriva period registracije od juna 1999. godine, a proces registracije je omogućen uz podršku Agencije za civilnu registraciju. Građani mogu podneti zahtev za registraciju od 1. februara	Januar- Jun	

	do 30. aprila 2025. godine.		
4	Saradnja sa Centralnim nivoom MZP-om • Redovni sastanci sa MKK u vezi sa procesom povratka i održivim rešenjima. • Sastanak sa predstavnicima MKK, kao i sa izbeglicama na temu: • Proces povratka na Kosovo iz Srbije i Crne Gore • Sastanak i saradnja u vezi sa onlajn sistemom.	Januar- Jun	
5	Saradnja sa Centralnim nivoom • Kosovski institut za lokalnu samoupravu organizovao je radionicu za diskusiju o sprovođenju zakonskog okvira u vezi sa pravima svojine. Projekat „Inicijativa za pravo na imovinu“ (NDP) se sprovodi od strane Centra za obuke i resurse za zagovaranje (ATRC), u saradnji sa Institutom za lokalnu samoupravu na Kosovu (KLGI), a finansira se od strane Svetske banke / Fonda za izgradnju mira i države. NDP ima za cilj da adresira ključnu potrebu za unapređenjem pristupa informacijama o registraciji zemljišta i imovine, kao i pružanje savetodavnih usluga u vezi sa imovinskim pravima za žene, mlade i ranjive grupe na Kosovu. • Odsek za tranzicionu pravdu u okviru Ministarstva pravde, u saradnji sa organizacijom Integra, organizovao je okrugli sto na temu: „Strategija za tranzicionu pravdu: Kako dalje?“ Cilj okruglog stola bio je procena i diskusija o stavovima, zabrinutostima i drugim pitanjima u vezi sa Strategijom za tranzicionu pravdu, koja je usvojena u junu prošle godine, pružajući tako priliku da se razmotre najbolji načini za napredak u sprovođenju Strategije za tranzicionu pravdu, kao i dalje unapređenje ljudskih prava na Kosovu.	Januar- Jun	
6	Saradnja sa Kosovskom Policijom i BSK -om: • Redovni mesečni sastanci o pitanjima zajednica u opštini Peć. • Kampanja za novi konkurs koji je raspisala KBS za regrutaciju novih kadeta.	Januar- Jun	
7	Saradnja sa nevladinim organizacijama: • Saradnja sa IOM-om na projektu stabilizacije zajednica (projekat je u procesu realizacije), kao i prijem i isporuka radnih sredstava za korisnike. • Saradnja sa IOM-om u vezi sa projektom RRK V – u vezi sa posetama interno raseljenim licima u Crnoj Gori i Srbiji. • Organizacija za Bezbednost i Saradnju u Evropi (OSCE), Regionalni centar u Peći, organizovaće tri (3) okrugla stola (do sada su održana 2). Tokom planiranih aktivnosti, učesnici će imati priliku da	Januar- Jun	

	diskutuju o najboljim praksama, radnim planovima, izazovima u sprovođenju, povratku i reintegraciji članova povratničkih zajednica u odgovarajuće opštine. • Organizacija za Bezbednost i Saradnju u Evropi (OSCE) je organizovala okrugli sto kao deo projekta „Unapređenje prava zajednica kroz podsticanje dijaloga između zajednica i izgradnju poverenja između zajednica i institucija“. Cilj je kreiranje sigurne i inkluzivne platforme za međusobnu razmenu između žena iz manjinskih zajednica i institucionalnih predstavnika, podstičući njihovo učešće u lokalnim mehanizmima bezbednosti i donošenja odluka. • Kosovski centar za rehabilitaciju preživelih tortura (KCRPT), u saradnji sa Profesionalnim savetom za socijalne i porodične usluge (KPSPSU) i Odeljenjem za planiranje, licenciranje i obuku (DPLT) pri Ministarstvu pravde, organizovao je trodnevnu obuku, koja se održava u okviru modula „Rad sa migrantima, izbeglicama, povratnicima i reintegrisanima“. Cilj ove obuke je jačanje kapaciteta institucionalnih službenika i pružalaca socijalnih i porodičnih usluga u oblasti rada sa pitanjima vezanim za migrante, izbeglice, povratnike i reintegrisane, sa posebnim fokusom na informisan pristup traumama i izazovnim iskustvima ovih grupa. • Kosovski centar za rehabilitaciju preživelih tortura (KCRPT), u okviru projekta „Podrška socio-ekonomskoj reintegraciji i obezbeđenju jednakih prava za učešće žena i devojaka koje su reintegrisane ili izbeglice na Kosovu“, u saradnji sa OKZP-om, organizovao je javni informativni događaj u opštini Peć.		
8	Saradnja sa ostalim Direktoratima : • Učešće na Opštinskoj Komisiji za Reintegraciju (OKR) • Komitet za Zajednice (KK) • Komitet za Politiku i finansije (KPF) • Opštinski Odbor za Bezbednost u Zajednici (OOBZ) • Skupština Opštine KKR je održao 2 sastanak na kojem su razmotrena 3 predmeta (Zahtjev); - 3 Zahtjeva za smještaj • Tokom ovog perioda, OKZP je učestvovala na tri sastanka u Opštinskom Odboru za Bezbednost u Zajednici (OOBZ).	Januar- Jun	
9	Pružanje pomoći, usluga i davanje informacija strankama i verifikacija na terenu • ZKKK pruža usluge, savetuje strane na dnevnoj bazi u vezi sa povratkom, reintegracijom i pravima zajednica.	Januar- Jun	

- | | | |
|--|--|--|
| <ul style="list-style-type: none">• U ovom periodu, ZKKK je obavio terenske posete povratnicima, reintegrisanim osobama i svim zajednicama kako bi pratio njihovu reintegraciju u društvo i prikupio informacije o njihovim problemima i potrebama. Posete su izvršene u:• Nakelj• Levoša i Bellopoje• Lutoglav i Terstenik• Dardania III i Firaja• Dardania II i Vitomirica• Treboviq• Sigë i Bresovik• Gorazhdevc• Zahaq• Qyshk i Bllagaje | | |
|--|--|--|

Sabahudi Ciriković

Opštinska Kancelarija za
Zajednice i Povratak

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim Sabahudi Cirikovic sabahudin.cirikoviq@rks-gov.net 045 724 000	 KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEÇ MUNICIPALITY OF PEJA	PERIUDHA RAPORTUESE JAN - QERSHOR DATA: 26.06.2025
--	--	---

Nr. Ref.	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës e për Janar – Qershor 2025	Muaji i realizimit	Çmimi i planifikuar në Euro
1	Monitorimi ditor i sistemit online të Ministrisë Punëve të Brendshme për personat e riatdhesuar në orën 08:00 dhe 14:00. Spektori për Riintegrim dhe të Drejtat e Komuniteteve janë pranuar 3 raste të riatdhesimit përmes sistemit online.	Janar- Qershor	
2	Monitorimi ditor i Intranetit (Sistemi Elektronik) – nuk kemi pasur kërkesë.	Janar- Qershor	
3	Bashkëpunimi me nivelin qendror të MPB-së si dhe me zyrën rajonale të MPB-së lidhur me procesin te riatdhesimit : - Bashkëpunimi (konsultimet) me koordinatorin rajonal nga zyra MPB-ës, lidhur me verifikimin në terren brenda 5 ditëve të personave të riatdhesuar sipas rregullores nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të kthyer dhe për menaxhimin e programit të riintegrit. - Bashkëpunimi me MPB -sektorin e menaxhimit të rasteve rajonale, lidhur me verifikimin e të dhënave të rasteve të riatdhesuar si dhe plotësimin e të dhënave të të njëjtit në sistemin online. - Punëtorija për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KKR-ve, e organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme / Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, me mbështetjen e GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. - Ministria e Punëve të Brendshme ka mbajtur një punëtori me temën ‘Të drejtat e refugjatëve në Kosovë dhe përgjegjësitë e komunave’, e cila u mbështet nga Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë dhe kishte për qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe shkëmbimin e përvojave për përmirësimin e qasjes në të drejtat dhe shërbimet për refugjatët dhe personat me mbrojtje ndërkombëtare, me fokus në rolin e komunave në procesin e integrit. - Ministria e Punëve të Brendshme ka mundësuar regjistrimin e qytetarëve që deri më tani nuk kanë qenë të regjistruar dhe si pasojë nuk disponojnë dokumente personale të Republikës së Kosovës. Ky vendim mbulon periudhën e regjistrimit që nga	Janar- Qershor	

	qershori i vitit 1999, ndërsa procesi i regjistrimit është mundësuar me mbështetjen e Agjencisë për Regjistrimin Civil. Qytetarët mund të dorëzojnë kërkesën për regjistrim nga 1 shkurti deri më 30 prill 2025.		
4	Bashkëpunimi me nivelin qendror të MKK-së - Takimet e rregullta me MKK-në lidhur me procesin e kthimit dhe zgjidhje të qëndrueshme. - Takim me përfaqësuesit e MKK-së si dhe me refugjatet me temën: - Procesi i kthimit në Kosovë nga Serbia dhe Mali i Zi - Takimi dhe bashkëpunim lidhur me online sistem	Janar- Qershor	
5	Bashkëpunimi me nivelin qendror - Instituti Kosovare për Qeverisje Lokale ka organizuar një punëtori për diskutimin e implementimit të kuadrit ligjor në lidhje me të drejtat e pronësisë. Projekti „Nisma për të Drejtën e Pronës“ (NDP) zbatohet nga Qendra për Trajnime dhe Burime për Avokim (ATRC), në bashkë-zbatim me Institutin e Qeverisjes Lokale në Kosovë (KLGI), dhe financohet nga Banka Botërore / Fondi për Paqe dhe Ndërtim Shteti. NDP synon të adresojë nevojën kritike për përmirësimin e qasjes në informacion për regjistrimin e tokës dhe pronës, si dhe ofrimin e shërbimeve këshilluese lidhur me të drejtat pronësore për gratë, të rinjtë dhe grupet e cënueshme në Kosovë. - Departamenti për drejtësinë tranzicionale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me organizatën Integra, ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me temë: ‘Strategjia për drejtësinë tranzicionale: Si të vazhdojmë më tej’. Qëllimi i tryezës së rrumbullakët ishte vlerësimi dhe diskutimi mbi qëndrimet, shqetësimet dhe çështjet e tjera lidhur me Strategjinë për drejtësinë tranzicionale, e miratuar në qershor të vitit të kaluar, duke ofruar kështu mundësinë për të shqyrtuar mënyrat më të mira për përparimin në zbatimin e Strategjisë për drejtësinë tranzicionale, dhe përmirësimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut në Kosovë.	Janar- Qershor	
6	Bashkëpunimi me Policin e Kosovës dhe FSK-në - Takime të rregullta mujore për çështje të komuniteteve në komunën e Pejës. - Kampanja për konkursin e ri të shpallur nga FSK për rekrutimin e katedve të rinje.	Janar- Qershor	

7	Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare: - Bashkëpunim me IOM-in në projektin e stabilizimit të komuniteteve (projekti në proces realizimi), si dhe pranimi dhe dorëzimi i mjeteve të punës për përfituesit. - Bashkëpunim me IOM-in lidhur me projektin për RRK V – në lidhje me vizitën e të zhvendosurve në Mal të Zi dhe Serbi - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Qendra Rajonale në Pejë do të organizojë tri (3) tryeza të rrumbullakëta (deri tani janë organizuar 2). Gjatë aktiviteteve të planifikuara, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të diskutojnë për praktikat më të mira, planet e punës, sfidat në zbatim, rikthimin dhe riintegrimin e anëtarëve të rikthyer të komuniteteve në komunat përkatëse. - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka organizuar një tryezë të rrumbullakët diskutimi si pjesë e projektit “Avancimi i të Drejtave të Komuniteteve përmes nxitjes së dialogut mes komuniteteve dhe ndërtimit të besimit mes komuniteteve dhe institucioneve”. Qëllimi është krijimi i një platforme të sigurt dhe gjithëpërfshirëse për këmbim të ndërsjellë ndërmjet grave nga komunitetet joshumicë dhe përfaqësuesve institucionalë, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në mekanizmat lokalë të sigurisë dhe të vendimmarrjes. - Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), në bashkëpunim me Këshillin Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF) dhe Divizionin për Planifikim, Licencim dhe Trajnim (DPLT) pranë Ministrisë së Drejtësisë, ka organizuar një trajnim tre-ditor, i cili mbahet në kuadër të modulit ‘Puna me migrantë, refugjatë, të rikthyer dhe të riatdhesuar’. Qëllimi i këtij trajnimi është fuqizimi i kapaciteteve të zyrtarëve institucionalë dhe ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në fushën e trajtimit të çështjeve që lidhen me migrantët, refugjatët, të rikthyerit dhe të riatdhesuarit, me fokus të veçantë në qasjen e informuar mbi traumat dhe përvojat sfiduese të këtyre grupeve.” - Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), në kuadër të projektit “Mbështetja e ri/integrimit socio-ekonomik dhe sigurimi i të drejtave të barabarta të pjesëmarrjes për gratë dhe vajzat e riatdhesuara dhe refugjate në Kosovë”, në bashkëpunim me OKZP-në, ka organizuar një ngjarje informuese publike në Komunën e Pejës.	Janar- Qershor	
8	Bashkëpunimi me drejtoritë komunale: - Pjesëmarrje ne Komision Komunal për Riintegrim (KKR) - Komiteti për Komunitete (KK) - Komitet për politik dhe financa (KPF) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)	Janar- Qershor	

	• Kuvendi Komunal - KKR ka mbajtur 2 mbledhje në të cilat janë shqyrtuar 2 raste (Kërkesë); - 2 Kërkesa për Akomodim - Gjatë kësaj periudhe kohore ZKKK-ja ka marr pjesë në tri takime në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS)		
9	Ofrimi i asistencës, shërbimeve dhe dhënies së informacionit për palët dhe verifikimi në teren. • ZKKK ofron shërbime, këshillon palët në baza ditore si për kthimin, riintegrimin dhe të drejtat e komuniteteve. • ZKKK-ja në këtë periudhë kohore ka bërë vizita në teren të kthyerve, personave të riatdhesuar dhe të gjitha komuniteteve për të parë riintegrimin e tyre në shoqëri dhe për të marrë informacion për problemet dhe nevojat e tyre. Vizitat janë bërë në: - Nakëll - Levoshë dhe Bellopojë - Lutogllavë dhe Tërstenik - Dardania III dhe Firaja - Dardania II dhe Vitomirica - Treboviq - Sigë dhe Bresovik. - Gorazhdevc - Zahaq - Qyshk dhe Bllagaje	Janar- Qershor	

Sabahudi Cirikovic

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim